

# albISLAM

revistë e përmuajshme fetare kulturore shkencore



## Votimet, mes dëmit dhe dobisë

■ Faqe 22  
**Mbrëmja e  
maturës -  
"Maturomanla"**

■ Faqe 37  
**Kamata dhe  
historiku  
I saj**

■ Faqe 48  
**Si të bëhesh  
nënë më e  
lumtur**

ISSN 1409-6250



9 771409 625002

Kryeredaktor:  
Omer BERISHA

Redaksia:  
Bekir HALIMI, Talha KURTISHI,  
Muhamed DËRMAKU, Agim BEKIRI,  
Alaudin ABAZI, Ali SHABANI,  
Lulzim SUSURI, Enver AZIZI,  
Ulvi FEJZULLAHU  
Sedat SHABANI

Bashkëpunëtorë:  
Ekrem AVDIU, Ismail BARDHOSHI,  
Enis RAMA, Ahmed KALAJA, Fadil MUSLIU

Redaktor gjuhësor:  
Fatmir Baçi  
Redaktor teknik & faqësës:  
Halil BERISHA  
Redaktor artistik & diseni:  
Azem ZAIMI

Adresa:  
rr: 110 nr: 5, Çarshia e vjetër  
Shkup 1000  
e-mail: albislam@gmail.com  
sms: +389 75 436 718  
tel & fax: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar  
pranë Agjencisë për Informata  
të Maqedonisë nr. 02-124/2  
ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 1400

ABONIMI NJËVJEÇAR  
Për Maqedoni: 600 den, Evropë: 20 €,  
Kanada dhe Amerikë: 40 €  
(në çmim janë të përfshira edhe  
harxhimet postare)

NUN-R DOOEL  
Xhironlogaria: 300000001759616  
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (denar)  
Xhironlogaria: 0270100209184  
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (euro)  
Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4  
S.W.I.F.T. : KOBSMK2X  
IBAN MK07300701002091869  
Numri tatimor: 4030003487017

**alb**  
**ISLAM**

DEL NË FILLIM TË MUAJIT

# AudioNur

## ISLAMI NE GJUHEN SHQIPE



Materiale në audio - Ligjërata  
Audiolibra - Pyetje&Përgjigje.

Ligjërata në video

Radio Audionur

Program i larmishëm dhe ligjërata të drejtpërdrejta

Radio Kuran

Lexim i Kuranit nga imamët më të famshëm

Libra - Quize - Forum. etj.

Mbi 40 GB materiale

[www.audionur.com](http://www.audionur.com)





# TË JETUARIT MES FATIT, RRETHANAVE DHE INICIATIVËS

3

UJ  
A  
R  
O  
R  
I  
T  
O  
R  
I  
E  
P  
I  
T  
O  
R  
I

**D**erisa i shikojmë njerëzit se si ballafaqohen me dallgët e jetës, vërejmë se disa syresh jetën e konsiderojnë thjeshtë një fat i cili i ka goditur dhe ata, në paaftësi për tu orientuar kah ajo që për problemet e tyre do të ishte zgjidhje dhe për vështirësitë rrugëdalje, pajtohen me atë fat duke menduar se kështu duhet të jetë dunjaja. Disa të tjerë, jetën nuk e kuptojnë ndryshe përveçse si rrethana, në vorbullën e të cilave ata kanë pikur nga kush e di ku dhe e vetmja gjë që u mbetet është të aklimatizohen me ato rrethana. Të tillët nuk (orvaten të) kuptojnë se rrethanat nuk ekzistojnë vetvetiu. Ato krijohen si pasojë e një grumbulli situatash në epiqendrë të të cilave padyshim është vet njeriu. Nëse ky tregohet pasivë atëherë ato rrethana bëhen të ngjashme me një kënetë, uji i së cilës jo vetëm që nuk rrjedh por bëhet depони e fundërrinave dhe gjërave të pavlefshme.

Të paktë janë ata që në arenën e pamëshirshme të sfidave dhe vështirësive hyjnë të udhëhequr nga iniciativa dhe vullneti i çeliktë për aksion dhe aktivitet. Të këtillët pajtohen me rrethanat si Caktim i Allahut të Plotfuqishëm por vetëm pasi ato të jenë bërë pjesë e të kaluarës në të cilën këta kanë dhënë mundin dhe angazhimin maksimal për t'i ndryshuar ato. I Dërguari i Allahut, Muhamedi (shpëtimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) derisa ua mësonte shokëve të vet atë që duhet të besojnë lidhur me caktimin e gjithërealizueshëm të Allahut (kaderin) ua tërhoqi vërejtjen se ata assesi nuk duhet që duke qenë pasivë dhe pa ndërmarrë asgjë të presin realizimin e kaderit të Allahut. Ai, i pyetur se cili do të jetë ndikimi i veprimtarisë së individit në realizimin e përpiktë të kaderit, u tha: *“Veproni, sepse ndonjërit do t’i bëhet e lehtë dhe e mundshme ajo për çka është krijuar.”* Veproni, pra, mos pritni vetëm të shihni atë që ka caktuar Allahu.

I udhëhequr dhe inspiruar nga këto mësimë, sahabiu i nderuar Ukashe b. Mihsan u ngrit dhe kërkoi nga i Dërguari që ta lusë Allahun që ky të jetë një prej atyre shtatëdhjetë mijtëve që do të futen në xhenet pa dhënë llogari, dëshirë kjo që, me dëshminë e të Dërguarit iu realizua. Njëri që fill pas tij parashtrroi të njëjtën kërkesë, u privua nga ky privilegj i madh.

Athua, a ishte kjo një premi të cilën Ukashe e fitoi në lojë fati, vetëm e vetëm pse ngrii dorën dhe u paraqit i pari?! A ka ndodhur ndonjëherë që ndokush ta fitojë xhenetin në këtë mënyrë?! Assesi jo. Xheneti, e sidomos hyrja në të pa iu nënshtuar procesit të mundimshëm të dhënies llogari, nuk fitohet në këtë lloj mënyre. Kjo mirësi e madhe fitohet duke i plotësuar kushtet e parashtruara e të përmendura në fjalët e të Dërguarit. Vetëm pas plotësimit të këtyre kushteve duhet të kesh fat. Fati, pra është në aktivitet.

Allahu i Madhëruar në hadithin kudsij të shënuar në mënyrë autentike në Musnedin e Ahmedit, thotë: *“Bir i Ademit, ngrihu në këmbë për Mua, Unë do të ec kah ti. Ti ec kah Unë, Unë do të vrapoj kah ti.”*

**Në emër të redaksisë:  
Ekrem B. Avdiu**

# albiSLAM

**Faqe 5** Muslimanët dhe "Fitna"



**Faqe 10** Votimet, mes dëmit dhe dobisë



**Faqe 22** Mbrëmja e maturës - "Maturomania"



**Faqe 26** KTHIMI I FUNDIT



**Faqe 31** E ARDHMJA



**Faqe 33** Allahu nuk ka nevojë për njerëzit, atëherë, pse jemi krijuar?



**Faqe 37** Kamata dhe historiku i saj



**Faqe 46** Si të bëhesh nënë më e lumtur



**Faqe 49** Fëmija dhe të folurit e tij



**Faqe 52** A lejohen votimet?



**Faqe 57** Namazi nafle, vlera dhe llojet e tij



**Faqe 61** Rruga e grupit të shpëtuar



# Muslimanët dhe "Fitna"

5

"Fitna" është një film i poshtër, Kur'ani është i mbrojtur nga Allahu, por cila është detyra e myslimanëve?

- Mbrojtje dhe pastrim i Kur'anit  
Famëlartë nga supozimet e pavërteta të politikanit holandez

Dr. Halid b. Abdurahman eshShajjë

Bismilahir Rahmanir Rahim

Lavd-falënderimi i takon Zotit të botëve, përfundimi i mirë është për njerëzit e devotshëm dhe armiqësi nuk shprehim ndaj askujt përpos se ndaj zullumqarëve, ndërsa paqja e lavdërimi qofshin për pejgamberin tonë Muhamedin, por edhe për të gjithë pejgamberët e tjerë, për familjen e secilit prej tyre, për shokët e tyre dhe për të gjithë që ecin në rrugën e tyre.

Nga e gjithë bota, myslimanët para disa ditësh dëgjuan dhembje për hapin e politikanit ekstremist holandez, i cili nxori një film të shkurtër me emrin "Fitna". Ky film, duke zgjedhur gjëra të poshtra, synoi t'i bëjë keq Kur'anit Fisnik, duke shëmtuar autoritetin dhe duke penguar dritën dhe lulëzimin që Kur'ani sjell për tërë njerëzimin. Por, këtë s'do ta arrijë asnjëherë. Sidoqoftë, përballë kësaj pune të poshtër, duhet të sqarojmë disa gjëra:

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta



## Së pari: S'kemi drojë për Kur'anin

Kur'ani Fisnik është i mbrojtur nga Allahu, i izoluar nga çdo e pavërtetë konkrete apo kuptimore. Në Kur'an nuk mundet të haset asgjë e keqe, ndërsa fjalët e Allahut nuk ndryshohen dhe nuk ndërrohen derisa të përfundojë kjo botë, atëherë Kur'ani kthehet tek Allahu. Ai ka thënë: *"Ata që e mohojnë Fjalën Tonë përkujtuese, kur u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një Libër i Madhërisëm. Atij nuk mund t'i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej*

Aktuale

1 maj 2008  
25 Rebiul Ahir

alIBISLAM

*një të Urti që meriton të gjitha lavdet*". (Fussilet 41,42).

Prej mëshirës dhe bamirësisë së Zotit është se Ai mbrojti Librin e tij të madhërshëm dhe nuk e la nën mbrojtjen e krijesave: *"Ne e kemi zbritur Përkujtuesin dhe ne do ta mbrojmë atë"*. (Hixhër 9).

Dijetarët kanë thënë: Përkujtuesi (dhikri) i përmendur në këtë ajet nënkupton Kur'anin, mbrojtja e tij d.m.th. siguria nga ndërrimi dhe ndryshimi i tij. Këtë nuk e kish asnjë prej Librave të mëhershëm, prandaj çdo libër i mëhershëm është ndërruar, ndryshuar dhe shtrembëruar, pavarësisht në sasi të madhe apo të vogël, ndërsa ky Libër mbeti i mbrojtur në çdo aspekt edhe pse të pafetë dhe të prishurit tentuan të jenë faktorë për të bërë shtrembërimet. Kjo mbrojtje pra, ishte një nga mrekullitë më madhështore.

Allahu ka zgjedhur prej robërve të mirë të Tij syresh që do dalin në mbrojtje të Fesë dhe do ta kundërshtojnë secilin që akuzon Kur'anin apo shtrembëron kuptimet e tij dhe ashtu fjalët e shtrembëruesve bien në ujë pa asnjë vlerë. Deri tani, të gjitha akuzat dhe shtrembërimet që janë bërë ndaj Kur'anit, janë asgjësuar.

### **Së dyti: Prej detyrave tona ndaj Kur'anit:**

Fakti që Allahu ka marrë përsipër mbrojtjen e Kur'anit, nuk do të thotë që ne të rrimë dhe të mos kujdesemi për Librin e Zotit tonë, përkundrazi, është detyrë për secilin dhe njëherazi edhe nder i madh që të punojmë në çdo drejtim që mbron Kur'anin apo largon fyerjen që i drejtohet Kur'anit, qoftë konkretisht apo kuptimisht. Ata që janë

të caktuar për këtë detyrë janë robërit më të nderuar, melaqet e pastra, të ndershme dhe bamirëse, në krye të të cilëve është Xhibrili, alejhi selam, i cili kumtoi Fjalën e Zotit të zotëria i njerëzimit, Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, i cili e pranoi këtë shpallje dhe ua shpjegoi njerëzve më së miri, ia përcolli Umetit ashtu origjinal si e kishte pranuar, që kjo Fjalë të jetë udhëzimit dhe nur për gjithë njerëzimin pa përjashtim. *"Ai ndodhet në Faqe të nderuara, të lartësuara, të pastra, në duart e shkruesve (melaqe) të ndershëm dhe të drejtë"*. Abdurahman Sa'diu, pas këtyre ajeteve thotë: "E gjithë kjo është mbrojtje e Allahut për Librin e Tij, pasi këtë detyrë ua dha melaqeve të ndershëm, të fortë dhe të devotshëm".

Umeti Islam është i detyruar po ashtu të luajë rolin e vet kundrejt Kur'anit Fisnik. T'i kryejë ato detyra të cilat porositen nga tekstet e Sheriatit. I Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Feja është dashamirësi"*. "Për kë?", pyetën shokët e tij. *"Për Allahun, për Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, udhëheqësit e myslimanëve dhe myslimanët në përgjithësi"*, u përgjigj i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem. (Shënon Muslimi).

Ibn Rexhebi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Dashamirësia ndaj Librit të Tij, d.m.th., ta besosh, ta madhërosh, ta lartësosh, ta lexosh saktë, të respektosh urdhëresat dhe ndalesat që janë në të, të kuptosh dijen dhe fjalët e tij, të meditosh rreth ajeteve, t'i thërrasësh të tjerët ta besojnë dhe t'i bësh ballë shtrembërimit dhe akuzave të pafeve".

S'ka dyshim se kjo detyrë në rend të parë është për udhëheqësit dhe dije-

tarët e myslimanëve, pas të cilëve radhiten pasanikët, të cilët duhet të ofrojnë edhe ndihmën materiale për të arritur këtë qëllim të lartë.

### **Së treti: Mllef i kriminelëve ndaj Kur'anit:**

Këto tentime për të shëmtuar Kur'anin Fisnik nga ana e deputetit ekstremist nuk janë të çuditshme, jo vetëm nga ai, por nga të gjithë jobesimtarët. Këtij i kanë paraprirë shumë të këqij tjerë, madje, kjo vepër nuk është tërësisht individuale, kjo është e planifikuar dhe e qëllimshme. Allahu ka shpalosur në shumë ajete atë që gjendet në zemrat e armiqve të Fesë dhe ndjenjat që kanë kundërshtuar të shenjtave Islame. Ai ka thënë: *“Jobesimtarët thonë: Mos e dëgjoni këtë Kur'an! Flisni e qeshni me zë të lartë, që të ndërprisni leximin e tij”*. (Fusilet 26). *“Ata i ndalojnë të tjerët të besojnë në Kur'an, edhe vetë largohen nga ai. Por, vetëm veten dëmtojnë, ndonëse nuk e vënë re”*. (Enam 26). *“Thuaj: Ai është udhërrëfyes dhe shërim për besimtarët. Por ata që nuk besojnë, janë të shurdhër dhe të verbër, njësoj si të thirreshin prej vendeve të largëta”*. Po ashtu, Allahu na tregoi për pezmin e madh që jobesimtarët kanë ndaj Kur'anit dhe leximit të tij nga myslimanët: *“Kur atyre iu lexohen vargjet Tona të qarta, ti do të vësh në fytyrat e jobesimtarëve marazin; ata duan t'u vërsulen atyre që i lexojnë shpalljet Tona. Thuaj: A doni t'ju tregoj se çfarë është më e keqe se kjo? –*

**Këto tentime për të shëmtuar Kur'anin Fisnik nga ana e deputetit ekstremist nuk janë të çuditshme, jo vetëm nga ai, por nga të gjithë jobesimtarët. Këtij i kanë paraprirë shumë të këqij tjerë.**

*Zjarri i xhehenemit, të cilin Allahu ua ka premtuar atyre që nuk besojnë! Eh, sa vendbanim i shëmtuar është ai!”*. (Haxh 72).

### **Së katërti: “...ndoshta urreni diçka, por ajo është më mirë për ju”**

Kjo ngjarje, edhe pse i ka mërzitur dhe zemëruar zemrat e besimtarëve, shpresojmë që ta lartësojë edhe më këtë Libër krenar dhe pasuesit e tij. Te të gjithë myslimanët pamë pezmin e madh dhe vendosmërinë e sinqertë kundër kësaj dukurie, në shpirtitrat e të gjithë atyre u ngjallë dëshira për t'i mbrojtur të shenjtat e Islamit dhe për t'i bërë krenare. Prej gjërave, me të cilat do ta bënim Kur'anin krenar është prezantimi i tij dhe i porosive të tij për të gjithë botën, e cila do të bëjë përhapjen e porosive Kur'anore dhe do të rezultojë me imanin e shumë më shumë njerëzve sesa të atyre që janë mashtruar nga fyerjet që i janë bërë Kur'anit. Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Thuaj: Cila është dëshmia më e madhe?, dhe përgjigju: Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush. Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet. A mos vallë ju dëshmoni se, përveç Allahut ka edhe zota tjerë? Thuaj: Unë nuk dëshmoj. Thuaj: Vërtet, Ai është vetëm Një Zot dhe unë jam larg nga ato që ju ia shoqëroni Allahut (në adhurim)”*. (Enam 19). Ibën Kethiri ka thënë: *“Kujtdo që i arrin ky Kur'an, arabë, të tjerë, të zinj, të bardhë, njerëz*



qofshin apo xhind, të gjithëve u tërhiqet vërejtja nëpërmjet Kur'anit". Këtë kuptim, komentuesit e Kur'anit e kanë nxjerrë edhe nga ajeti: *"Ata që mohuan Përkujtuesin (dhikrin) kur u erdhi, ndërsa ai është Libër Krenar"*, nga përshkrimi i Kur'anit si Krenar mësojmë

se do fitojë dhe do të mbisundojë. Kjo në vete, përmban edhe kërcënim kundër fytyrës të Kur'anit. Për këtë ka urtësi të panumërta nga Allahu, të cilat nuk mund t'i vërejë e tërë logjika njerëzore. Atij i takon lavd-falënderimi në mënyrë si i ka hije vetëm Atij.

### **Së pesti: Mundësojani ta dëgjojnë Fjalën e Zotit:**

Qendrat Islamike dhe shoqatat që merren me dave (thirrje Islame) kanë për detyrë t'ua shfaqin jobesimtarëve realitetin e Kur'anit Fisnik, t'ua rrëfjnë udhëzimin dhe mëshirën që promovohet kundrejt atyre e gjithë njerëzimit, por larg shtrembërimeve të rënda dhe shëmtimeve të padrejta, me shpresë që kjo të jetë nur dhe udhëzim për ata. Për këtë, duhet shfrytëzuar masmediat dhe telekomunikimin e mundshëm si dhe rrjetin e internetit. Allahu ka thënë: *"Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti, mbroje, në mënyrë që të dëgjojnë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë"*.

(Teube 6). Abdurahman Sa'diu thotë: Shkaku për këtë është se jobesimtarët janë popull që nuk dinë dhe ndoshta vazhdimi i tyre në mosbesim bëhet

**Popujt perëndimorë sot nuk e njohin realitetin e Islamit, udhëzimet e Kur'anit dhe mëshirën që promovohet për tërë alemin.**

pikërisht nga mosdija, e cila, po të zëvendësohej me dije, do ta zgjidhnin Islamin. Prandaj, Allahu e urdhëroi të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, dhe kështu edhe Umetin e tij, që të mbrojnë ata jobesimtarë që kërkojnë të dëgjojnë fjalën e Allahut".

Popujt perëndimorë sot nuk e njohin realitetin e Islamit, udhëzimet e Kur'anit dhe mëshirën që promovohet për tërë alemin. Kjo gjë është arritur nga fushatat e ndryshme që janë bërë për të shëmtuar Islamin dhe për ta paraqitur atë me një pamje të kimit dhe prapambetjes. Kjo fushatë na detyron fort të japim një mund shkencor medial dhe të qytetëruar, për të nxjerrë në pah realitetin e porosisë së Kur'ani Kerimit.

Qëndrimi i qeverisë holandeze në krye me kryeministrin, i cili veprimi për të penguar këtë film nga qarkullimi dhe pas shfaqjes qortoi publikisht këtë gjest dhe tha se kjo është thirrje në urretje, është një qëndrim që ka të bëjë me drejtësinë dhe kjo duhet të shfrytëzohet për t'u bërë një fillim i bashkëpunimit kulturor midis asaj qeverie dhe institucioneve përkatëse, sikurse janë: Liga Islamike Botërore, al-Az'hari dhe Konferenca Islamike për të organizuar takime kulturore ku do të shpjegohej toleranca, mirësia dhe bamirësia që promovohet në Kur'an për tërë njerëzimin.

### **Së gjashti: A nuk kemi mundësi të ndërmarrim iniciativa?**

Nga fyerjet e fundit që u bënë kundrejt Kur'anit të madhërisëm dhe



Muhamedit, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të, vërejmë këta të prishur se ishin iniciatorë për të përhapur të pavërtetat, ndërsa shumica e qëndrimeve tona ishin mbrojtje dhe dënim ndaj atyre gjesteve. Prandaj, tani, pasi kemi përvojë me këto fyerje të njëpasnjëshme, nuk duhet të presim fyerjet e radhës, por e kemi detyrë që të marrim iniciativa për të bërë projekte udhëzuese për të gjitha nivelet e njerëzve. Duhet të mos harrojmë se filmi holandez “Fitna” që fyer Kur’anin nuk është bërë nga ndonjë mund i madh, ato janë vetëm pjesë të incizuara, të cilat janë montuar njëra me tjetrën, dhe është shpërndarë nga disa faqe të internetit. Këtë punë, mund ta bëjë vetëm një njeri me kompjuterin personal duke përdorur disa programe të mikrosftit apo të tjera. Sa mirë do ishte, sikur disa të specializuar myslimanë apo të tjerë që kanë pasion ndaj programeve kompjuterike, t’i kushtojnë një pjesë të kohës dhe aftësisë së tyre, për të bërë klipe të videos, ku do të shfaqin mirësitë e kësaj Feje Islame, të tregojnë mrekullitë, mirësitë dhe bamirësitë Kur’ani që flet për ato, të tregojnë se çfarë mundi kishte dhënë Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, që ky njerëzim të zgjohet dhe të gjejë lumturinë. Pasi të bëjnë këto montazhe, t’ua paraqesin hoxhallarëve dhe pastaj të shfaqen në internet dhe në gjuhë të ndryshme. Ky është vetëm një shembull dhe vetëm një plan për të filluar një iniciativë të mirë, ndërsa shembujt janë të shumtë dhe të llojllojshëm. Por, sa i përket rezultateve dhe fryteve, këto i takojnë vetëm Allahut të Lartësuar.

### **Së shtati: “...ejani të biem në një fjalë të përbashkët...”:**

Duke përcjellë fyerjet e njëpasnjëshme që po u bëhen të shenjtave të myslimanëve, vërejmë se këto fyerje mund të jenë shans që të krishterët dhe të tjerët, t’i përkujtojmë që të jenë prej atyre, të cilët i përshkroi Allahu në Librin e Tij: *“Midis ithtarëve të Librit, me siguri ka të atillë që e besojnë Allahun dhe atë që ju është shpallur juve, si dhe atë që u është shpallur atyre, duke qenë të përuhur para Allahut dhe pa i këmbyer shpalljet e Tij me ndonjë vlerë të paktë. Ata do të kenë shpërblimin e tyre te Zoti i tyre. Vërtet, Allahu është i shpejtë në llogari!”*. (Ali Imran 199).

Njashtu, ai ka urdhëruar: *“Thuaj, o ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush, se do të adhurojmë vetëm Allahun, se nuk do t’i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut! Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!”*. (Ali Imran 64).

Le ta dijë e gjithë bota se Islami nuk ka për qëllim të vrasë asnjë krijesë me të padrejtë dhe as nuk e detyron njeriun në atë që nuk do dhe nuk e pëlqen. Islami është kështu si e ka përshkruar të Dërguarin e Tij: *“Nuk të kemi të dërguar për diçka tjetër, përveçse mëshirë për të gjithë”*. (Enbija 107).

Allahu i udhëzoftë të gjithë nga e drejta, ndërsa lavdërimi e shpëtimi janë për Muhamedin, pejgamberin tonë.

**Përktheu: Omer BERISHA**

# VOTIMET, mes dëmit dhe dobisë

Votimet mes urtësisë së dijetarëve dhe entuziazmit të rinisë

**Bekir HALIMI**

**S**i zakonisht, kur afrohet koha e votimeve dhe e zgjedhjeve, në vende të ndryshme të myslimanëve nisin edhe debatet rreth qëndrimit të shëndoshë në lidhje me këto procese; dikush mban qëndrim refuzues, madje, kategorik ndaj tyre, duke i etiketuar me mosbesim të secilit që përkrah pjesëmarrjen në këto procese, të tjerët zhyten tërësisht në këto procese dhe harrohen në aksion dhe i shmangen qëllimit, kurse të tjerët mundohen të jenë të përpiktë dhe të mundohen që qëndrimin e tyre rreth këtyre fenomeneve ta ndërtojnë në bazë të vlerësimit të interesit të myslimanëve në këto procese.

Ajo që e dallon zakonisht këtë proces është zhurma e madhe që ngrihet në disa vende mes të rinjve, të cilët nuk janë mësuar të dëgjojnë dijetarët rreth këtyre çështjeve, por i marrin nga njerëz të vegjël në dije dhe u imponojnë qëndrimin se në këso raste duhet vendosmëri dhe paluhatsmëri, sepse në pyetje është imani dhe kufri.

Disa njerëz, edhe pse janë të pakët në numër, pjesëmarrjen në votime e kategorizojnë si kufër, për të pakësuar

të keqen dhe për të shtuar të mirën; kurse disa të tjerë japin fetva, si kafira dhe mosbesimtarë, dhe me këtë pa dyshim se ua kanë kaluar edhe mentorëve të tyre.

Për të sheshuar këto dilema dhe për t'ua lehtësuar myslimanëve kuptimin e kësaj çështjeje, menduam të shkruanim këto reshta. Allahu na qoftë në ndihmë!

Fillimisht, duhet përmendur një çështje shumë me rëndësi, të cilën dikush mundohet ta përziejë dhe t'i japë kahe tjetër, duke u nisur nga këto sqarime që bëjmë në lidhje me votimet dhe zgjedhjet parlamentare.

Andaj, në fillim do përmendim disa rregulla të përgjithshme që kanë të bëjnë me këtë çështje.

## **Një: Pushteti i takon vetëm Allahut.**

S'ka dyshim që sipas botëkuptimit fetar Islam sovraniteti absolut i takon vetëm Allahut, tebareke ue teala, dhe askujt tjetër përpos Tij, kurse demokracia është formë politike ku populli qeveris vetveten dhe është në kundërshtim total me këtë rregull,



pasi vetëm Allahut i takon pushteti dhe se çdo vendim që është në kundërshtim me vendimin e Allahut, pa marrë parasysh se a ka të bëjë për ndonjë çështje të vogël ose të madhe, është i refuzuar dhe i pa vlerë për myslimanët. Andaj kushdo që qeveris dhe nuk i përmbahet urdhrat dhe ligjeve të Allahut, është *tagut*, dhe kushdo që është dakord me ligjin që bie ndesh me ligjin e Allahut, duke e ditur mirë këtë gjë, është jobesimtar, sepse nuk respektohet krijesa në të bërit mëkat ndaj Krijuesit, kurse edhe qasja selektive e fesë me vetë-dëshirë është mosbesim.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “... pra i tërë sundimi është në duart e Allahut, të Lartit, të Madhëruarit!”. (Gafir: 12); “...vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon kujt, pos Allahut, e

*Ai urdhëroi të mos adhuronit tjetër vetëm Atë. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë”. (Jusuf: 40); “A nuk është Allahu më i urti i gjykuesve?”. (Et-Tin: 8); “Thuaj: “Allahu e di më së miri sa kanë ndenjtur, Atij i takon fshehtësia e qiejve dhe e tokës. Çfarë (i çuditshëm) është të parit e Tij dhe çfarë është të dëgjuarit e Tij! Pos Tij ata (njerëzit) nuk kanë ndihmetarë. Në vendimin e Tij nuk mund t’i përzihet askush”. (El-Kehf: 26); “A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i Allahut?”. (El-Maide: 50).*

#### Dy: Realiteti i sotëm

Myslmanët sot ose jetojnë si shumicë në shtetet që qeverisen në formë

monarkie, ose demokratike ose tirane, ose si një pjesë e shoqërive ku myslimanët si pjesë autoktone e këtyre vendeve diku janë shumicë e diku janë pakicë, e zakonisht në vokabularin modern përdoren si **vende ku myslimanët janë pakicë**. Në këto vende të dyta, një pjesë e madhe ka jetuar nën pushtetin komunist, i cili e ka luftuar totalisht fenë dhe ndikimin fetar dhe që më vonë, me rënien e sistemit komunist, të shndërrohen në shtete demokratike dhe sistem shumëpartiak. Domethënë ata jetojnë në injorancë të madhe fetare, devijim dhe degjenerim moral dhe presion politik, fetar dhe kombëtar.

Divergjencia lind në formën fetare të bashkëveprimit me këto pushtete. Andaj, duke lexuar mendimin e aktivistëve islamikë në lidhje me këtë çështje, na dalin disa opsione dhe qëndrime, prej tyre:

### 1. Grupacioni i xhihadit dhe tekfirit

Sipas tyre, pushtetet momentale duhet të luftohen me armë, këto qeveri duhet të shemben me dhunë dhe se vrasja e tyre dhe atyre me të cilët mbrohet ushtria, policia, sigurimi etj. lejohet, dhe se kjo është mënyra e vetme e kthimit të qeverisjes me ligj të Allahut. Ky grup njerëzish mendon se pranimi i posteve shtetërore, hyrja dhe pjesëmarrja në parlament është kufër dhe fe-mohim.

Natyrisht, dijetarët bashkëkohorë të Ehli Sunetit e kanë kundërshtuar këtë qëndrim dhe opSION dhe kanë vlerësuar se këta njerëz, edhe në qoftë se në bazë janë nisur nga parimet e Ehli Sunetit, kanë rënë nën ndikim të shkollës së vjetër të Havarixhëve, të

cilët e shohin si obligim të tyre ndryshimin e pushtetarëve me dhunë dhe gjak dhe me këtë janë larguar nga metoda e Ehli Sunetit, dikush më shumë e dikush më pak.

### 2. Iluministët islamikë (el-fikr el-mustenir)

Ky grup njerëzish mundohet të bëjë kompromis në parimet e fesë si dhe një kombinim mes parimeve të demokracisë dhe parimeve të Sheriatit, duke thënë se s'ka kundërshtim mes demokracisë dhe **shurës** islame, se qeveritë në botën islame në shumicën e rasteve gjykojnë me ligje të Sheriatit, përpos në disa çështje që janë të pakta në numër. Këta janë të gatshëm të bëjnë lëshime në shumë parime të rëndësishme të fesë, si: mosvlerësimi i dallimeve mes fesë Islame dhe feve tjera, lejimi i bankave që punojnë me kamatë, inkurajimi i **ixhtihadit** të pa rregulluar me rregullat e Sheriatit, tejkalimi i shumë rregullave të Sunetit dhe ixhmasë, konsiderimi i logjikës dhe interesit si kriter vendimtar dhe përfundimtar në dispozitat fetare etj. Këta njerëz kanë një metodë për të arsyetuar realitetin bashkëkohorë dhe përhapur devijimin e jo metodë për ta ndryshuar një realitet të caktuar dhe afruar me mësimet e fesë Islame.

### 3. Të izoluarit dhe pritësit (Ehlul-Uzleti vel-Intidhar)

Këta njerëz nuk kanë botëkuptim të qartë rreth ndryshimit të realitetit, as rreth mënyrës se bashkëveprimit me realitetin ekzistues, andaj edhe i japin prioritet izolimit dhe pritjes, madje, dikush shkon edhe më larg dhe e ndërlihd zgjimin islam dhe rikthimin e



pushtetit Islam me ardhjen e Mehdiut. Pa dyshim se kjo mënyrë pasive e shikimit të gjërave është në kundërshtim me rregullat e Sheriatit dhe porosive hyjnore për optimizëm, aktivitet dhe iniciativë të mirë.

#### 4. Ata që mundohen ta zbatojnë tërë Islamin

Ky grup i dijetarëve dhe aktivistëve islamikë mundohet të zbatojnë tërë fenë Islame në realitetin bashkëkohor me aq sa munden dhe sipas asaj që u mundësohet. Ata mendojnë se myslimanët duhet të zbatojnë tërë fenë Islame: në kuptim që në kohën e luftës dhe xhihadit duhet të luftohet dhe të bëhet xhihad për të mbrojtur Fenë, vendin, popullin dhe nderin e myslimanëve; në kohë të ndryshimit të së keqes duhet të ndryshohet e keqja sipas mundësive, ata mendojnë se procesi i përgatitjes së bartësve të fesë dhe thirrësve në fe të Allahut, është një proces i vazhdueshëm, edukimi i myslimanëve ndodh në mejdanin e zbatimit të asaj që e mësojnë dhe në mejdanin e xhihadit, ata nuk bëjnë dallime mes dijes dhe veprave etj.

Ky grup i dijetarëve mendon se një mejdan i madh i xhihadit, davetit dhe ndryshimit të së keqes, ose pakësimit të saj bëhet edhe me hyrjen në parlamente ose pranimin e posteve shtetërore (shih: “Meshruijetud-Duhuli Ila Mexhalisit-Teshriije”, Abdurahman Abdul-Halik, fq. 3-5).

#### Realiteti ynë

Ne, si myslimanë që jetojmë në këto vende që dominohen nga jomyslimanët dhe vetëdija fetare e myslimanëve është e dobët, kemi disa opsione para nesh, dhe më konkretisht:

- Opsionin e shkrirjes totale në këto shoqëri, vepër pa dyshim negative dhe e dëmshme për ne si myslimanë.

- Opsionin e izolimit dhe getoizimit, i cili gjithashtu i dëmton myslimanët dhe krijon imazh të gabuar për myslimanët, por edhe myslimanët i bën të paaftë për të ndikuar në rrjedhat e jetës së myslimanëve dhe tjerëve në vendin tonë.

- Integrimi parcial, i cili nënkupton përdorimin e çdo posti dhe mundësie për të ndikuar pozitivisht në rrjedhat e shoqërisë dhe për të ofruar alternativa, së paku të pjesshme, të problemeve me të cilat ballafaqohen myslimanët. Krejt kjo duke mos lëshuar pe aspak në principet e fesë dhe duke u ndier krenar me përkatësinë e kësaj feje.

Në këtë drejtim mund ta përmendim edhe një sqarim të shejhul Islam Ibën Tejmiut, Allahu e mëshiroftë, që vlen për situatat tona. Ai mes tjerash thotë: “Kur të bashkohen dy ndalesa (harame) dhe nuk mund ta lëmë më të madhen përpos duke e bërë më të voglën, në këtë rast bërja e ndalesës (haramit) më të vogël nuk është bërje e ndalesës në realitet edhe pse kjo vepër quhet lënie e detyrës (vaxhibit), kurse emërtimi i kësaj veprë ndalesë (haram) si emërtim absolut nuk e dëmton aspak. Kjo thuhet edhe për lënien e detyrës (vaxhibit) me arsye dhe bërjen e ndalesës për interes të sigurt ose për domosdoshmëri ose për të shtyrë atë që është më e ndaluar”. (“Mexhmuul-Fetava”, 20/57).

#### Rregullat fetare në lidhje me këtë çështje

Shejhul Islam, Ibën Tejmiu, rahimehullah, ka jetuar në një kohë të përafërt me kohën tonë, në kohën e tij

tatarët morën në dorë shtetin e myslimanëve, ata ishin injorantë dhe zul-lumqarë, disa herë gjykonin me islam e disa herë me adete dhe zakonet e tyre, përvetësuan një pjesë të madhe të pasurisë së myslimanëve, mirëpo pikërisht në këtë kohë ai jepte fetva se nuk lejohet të largohen njerëzit e mirë nga pushteti në këto shtete duke thënë: “Ai që merr përsipër ndonjë pjesë pushteti (*vilaje*) dhe synon që me këtë vepër të respektojë Allahun, të realizojë detyrat e mundshme dhe të largohet nga ndalesat e mundshme, nuk do të dënohet për atë që s’mund ta bëjë, sepse marrja e pushtetit nga njerëzit e mirë është më mirë sesa marrja e pushtetit nga njerëzit e këqij, edhe nëse s’arrijnë të qeverisin me gjithë atë që ka shpallur Allahu; nëse janë të paaftë për ta realizuar atë gjë (d.m.th. qeverisjen me tërë ligjin e Allahut).” (“Mexhmuul Fetava”, 28/369).

### **Qeverisja e njerëzve është detyrë fetare**

Shejhul Islam Ibën Tejmju, rahimehullah, duke folur në lidhje me këtë temë, mes tjerash thotë: “Duhet të dihet se qeverisja e njerëzve është prej detyrave më të mëdha fetare, pa të cilën nuk mund të ngrihet as feja e as dynjaja, sepse njerëzit nuk mund të realizojnë interesin e tyre përpos se duke u bashkuar mes vete, duhet të bashkohen në udhëheqjen e dikujt, madje, Pejgamberi, salAllahu alejhi ue

selem, ka thënë: “Kur të dalin tre persona në udhëtim, le të jetë njeri prej tyre udhëheqës i tyre”. (Sahih, Ebu Davudi)”.

Pasi i solli argumentet fetare për këtë çështje, pastaj tha: “Obligim është që qeverisjen ta konsiderojmë Fe dhe afrim tek Zoti, kurse afrimi tek Allahu duke respektuar Allahun dhe Pejgamberin, salallahu alejhi ue selem, është prej afrimeve më të mira”. Pastaj tregon se qeveritarët prishen nga shkak i lakmisë për pushtet dhe pasuri, kurse njerëzit e mirë dhe fetarë

**Qeveritarët prishen nga shkak i lakmisë për pushtet dhe pasuri, kurse njerëzit e mirë dhe fetarë e dëshirojnë pasurinë dhe pushtetin jo për mendjemadhësi, por për t’iu afruar Allahut.**

e dëshirojnë pasurinë dhe pushtetin jo për mendjemadhësi, por për t’iu afruar Allahut, tebareke ve teala, për të ngadhënjyer feja, për ta harxhuar pasurinë në rrugë të Allahut dhe se me këto veprime rregullohet Feja dhe dynjaja. Ai mes tjerash thotë: “Pasi shumica e qeveritarëve dëshirojnë pasurinë dhe autoritetin dhe largohen nga vërtetësia e besimit

(hakikatul-iman) në qeverisjen e tyre, shumë njerëz kanë menduar se qeverisja kundërshton besimin dhe plotësinë e fesë. Pastaj disa prej tyre që janë më fetarë janë larguar nga disa gjëra pa të cilat nuk plotësohet Feja (d.m.th pushteti dhe pasuria) kurse të tjerët kanë parë nevojën për to dhe kanë lënë fenë pas shpine, duke besuar se këto dy gjëra kundërshtohen mes vetes, kështu që feja tek ky njeri ka mbetur në pozitë të mëshirës dhe nënçmimit e jo në pozitë të epërsisë dhe krenarisë. Njëlloj me këta, kur ithtarët e librit nuk arritën të plotësojnë zbatimin e

fesë dhe frika nga sprovat që mund t'i godasin gjatë zbatimit të fesë, u dobësuan dhe e poshtëruan, duke menduar se nuk arrihet interesi i tij dhe i të tjerëve me fenë.

Këto dy metoda janë të gabuara, rruga e njerëzve fetarë, të cilët nuk e plotësuan fenë me pushtet, xhihad dhe pasuri dhe rruga e atyre që kanë marrë pushtet, xhihad dhe pasuri dhe nuk synojnë me këtë vepër realizimin e fesë, këto janë rrugët e atyre me të cilët Allahu është hidhëruar dhe rruga e atyre që kanë devijuar. Të parët janë të krishterët, kurse të dytët janë hebrenjtë”. (“Mexhmuul-Fetava”, 28/390- 397).

Myslmanët që jetojnë në vende të përziera me jomyslmanë në kohët e sotme nuk mund të realizojnë çdo interes dhe të largojnë çdo dëm, sepse nuk janë të vetëm, andaj, duhet nisur nga rregulli: **ajo që nuk arrihet e tëra nuk lihet e tëra.**

Nëse fetarisht e kemi detyrë ta ndryshojmë tërë të keqen, po patëm mundësi, ashtu na detyrohet ta ndryshojmë një pjesë, nëse nuk kemi mundësi ta ndryshojmë të gjithën, kjo hyn në radhën e të mundshmes, pasi etapizimi në ndryshim të keqes është zakon pejgamberik i pasuar dhe fikh i thellë i dijetarëve, pasi fikhu në kohërat e pushtetit dhe dominimit dallon nga fikhu në kohërat e dobësisë dhe dështimit dhe kanë të bëjnë me kuptimin e rolit të individit dhe kolektivit (xhematit) në lidhje me këto çështje. Shejhul Islam Ibën Tejmîu, rahimehullah, thotë: “Dijetari në raport me sqarimin dhe kumtimin mund të vendosë vonimin e tyre në lidhje me disa gjëra deri në kohën e dominimit dhe

pushtetit, ashtu sikurse ka heshtur Ligjvënësi në fillim urdhërimin e disa gjërave ose ndalimin e disave derisa u ngrit Islami dhe u shfaq. Kjo nuk futet në radhë të pajtimit me ndalesat dhe braktisjen e detyrave...”. (“Mexhmuul-Fetava”, 20/59).

Ndryshimi i të keqes nuk realizohet duke e bojkotuar të keqen dhe duke ua lënë hapësirën bosh para tyre, por duhet futur në procesin politik dhe të konkurrojmë e kundërshtojmë me fakte dhe argumente njerëzit që kanë oferta të rrejshme dhe të kota, gjithmonë me politikë dhe urtësi, sidomos kur pushteti dhe furia është në dorë të njerëzve të këqij.

Krejt kjo ka të bëjë me kuptimin e dispozitave fetare dhe objektivat e tyre, me njohjen e *fikhul Uaki* - fikhut të realitetit, *fikhul euleuijat* - fikhun e prioriteteve, *fikhul merhale* - fikhun e etapës, *fikhul muvazenat* - fikhun e baraspeshës mes interesit dhe dëmit, dhe me ndihmesën e procesit të përmirësimit të shoqërisë tonë, thyerjes të disa stereotipave që krijohen për myslimanët dhe shfrytëzimi i situatave për të ofruar alternativa parciale dhe momentale për popullin tonë.

Shejh AbduRahman Sa'diu, rahimehullah, duke komentuar ajetin Kuranor: “*Ata thanë: “O Shuajb, ne nuk po e kuptojmë shumicën nga ajo që thua dhe ne të konsiderojmë ty të dobët në mesin tonë, dhe sikur të mos ishte ai grup yti, ne do të gurëzonim ty, ngase ti nuk je i çmuar ndër ne”*”. (Hud: 91) Ky hoxhë duke i përmendur mësimet nga ky ajet thotë: “Allahu i mbron besimtarët me shumë shkaqe, disa mund t'i dinë e disa mund të mos i dinë aspak. Ndoshta i mbron

ata për shkak të fisit të tyre dhe banorët e vendit të vet jobesimtarë, ashtu sikurse e mbrojti Shuajbin, alejhiselam, nga gurëzimi i popullit të vet për shkak të fisit të tij. Andaj nuk prish punë që njeriu të insistojë në kujdesin ndaj lidhjeve farefisnore, me të cilat mbrohet feja Islame dhe myslimanët, madje mund edhe të obligohet kjo gjë, sepse përmirësimi është i kërkuar sipas mundësisë. Për këtë, nëse myslimanët që jetojnë nën pushtet të jomyslimanëve veprojnë për të bërë një shtet republikë, ku njerëzit, si individ dhe popuj do të gëzojnë të drejtat e tyre fetare dhe botërore, do të ishte më prioritare sesa nënshtrimi ndaj një shteti, i cili ua shkel të drejtat e tyre fetare dhe botërore, kujdeset për t'i shfarosë ata dhe punon për t'i bërë shërbëtorë dhe servilë të tyre. Po, nëse shteti mund të bëhet i myslimanëve dhe ata të gjykojnë në të, kjo veper është **detyrë**, mirëpo nëse nuk mund të arrihet kjo shkallë, atëherë shkalla e cila siguron mbrojtje të fesë dhe dynjasë ka prioritet. Allahu e di më së miri". (Tejsirul-Kerimir-Rahman", 2/289).

Rasti i Nexhashiut, i cili, edhe pse u bë mysliman, vazhdoi të jetë mbret i Abisinisë. Edhe ky rast është shumë i rëndësishëm për të kuptuar sa më drejtë këtë çështje. Ai besonte në Muhamedin, salAllahu alejhi ue selem dhe vdiq si mysliman, andaj Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, ia fali namazin e xhenazes këtij njeriu. Ky njeri, edhe pse ishte besimtar dhe mysliman, mbeti si mbret i një populli i cili i tëri ishte

jobesimtar, kundërshtar të monoteizmit dhe refuzues të Fesë. Ai në mesin e tyre ishte i drejtë dhe bamirës me aq sa kishte mundësi, edhe pse populli ishte në kufër dhe shirk, andaj mbetja e tij në këtë pozitë ishte më mirë se braktisja e kësaj pozite për ta marrë ai që do të prishte çdo gjë. S'ka dyshim se metoda e Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, në thirrje në fe të Allahut ishte arritja e interesit dhe plotësimi i tij dhe thirrja në fe të Allahut sipas mundësive, pasi askush nuk mund ta arrijë drejtësinë

tërësisht dhe të bëjë çdo veper në formën më të plotë. Për këtë shkak pakësimi i të keqes deri në minimum dhe arritja e interesit deri në maksimum është metodë pejgamberike. Në tregimin e takimit të Nexhashiut me myslimanët në fund thotë: "Po mos ta kisha këtë

mbretëri, do të kisha ardhur për t'u bërë unë ai që do t'i bartja këpucët." (shih: "El-Bidaje uen-Nihaje", 2/67). Ky njeri, edhe pse besoi si duhet në Isain dhe Muhamedin, salAllahu alejhi- ma ue selem, mbeti në mbretërinë e tij duke qeverisur një popull jobesimtar, të cilët nuk u bënë besimtar si ai. Po të kishte qenë prej detyrimeve të Islamit braktisja e postit dhe largimi nga kjo qeverisje, nuk do ta kishte lënë Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, në këtë post dhe nuk do ta kishte cilësuar si njeri të mirë dhe nuk do të kishte urdhëruar sahabet t'ia falin namazin e xhenazes. (shiko: "Meshruijetud-Duhuli Ila Mexhalisit-teshriije", fq. 10-12).

**Për këtë shkak pakësimi i të keqes deri në minimum dhe arritja e interesit deri në maksimum është metodë pejgamberike.**



### **Këtyre sqarimeve dhe tjerave që do vijojnë u bashkëngjisim edhe disa fetva.**

**Komisioni i përhershëm për fetva** në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ka dhënë fetva se lejohet pjesëmarrja në votime edhe atë me rastin e parashtrimit të pyetjes nga myslimanët e Algjerisë në lidhje me votimet atje. Komisioni ka qenë i përbërë nga shejh Ibën Bazi, kryetar i komisionit, shejh Abdurezak Afifi dhe shejh Abdullah Gudejani. Shiko librin “Fetval-Lexhnetid-Daime”, 1/373.

**Asambleja e fikhut** me seli në Xhide, ka dhënë fetva se lejohet pjesëmarrja në votime edhe në vende ku myslimanët janë pakicë. Shiko vendimin e pestë në takimin e nëntëmbëdhjetë. Rezymeja e vendimit gjendet e përkthyer te rubrika e pyetjeve dhe përgjigjeve, të këtij numri.

Ky ka qenë qëndrimi edhe i **shejh Ibën Bazit**, rahimehullah, të cilin, kur e kanë pyetur se a është i ligjshëm fetarisht kandidimi për parlament dhe vendimi i fesë Islame për nxjerrjen e kartelës së votimit, me qëllim të votimit të thirrësve islamë dhe njerëzve fetarë, ai është përgjigjur: “Pejgamberi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Veprat vlerësohen sipas qëllimit, kurse çdo njeriut i takon ajo që ka për qëllim”*. Andaj nuk ka problem nëse njeriu hyn në parlament, nëse ka për qëllim përkrahjen e të vërtetës dhe mospajtimin me të kotën, sepse kështu ndihmohet e vërteta dhe u bashkohemi thirrësve në fe të Allahut.

Gjithashtu nuk ka problem të nxirret kartela me të cilën njeriu arrin të votojë thirrësit islamikë dhe për të ndihmuar të vërtetën dhe njerëzit e të vërtetës. Allahu është Ai që jep suk-

ses”. (Shiko: “Muavikat tatbik esh-Sherijatil-Islamije”, Mena Katan, fq. 166).

Kur i parashtruan hoxhës së madh dhe njohësit të mirë të akides në shekullin tonë, shejh Ibën Uthejminit pyetjen rreth pjesëmarrjes në votime, ai shkoi edhe më larg se të tjerët dhe tha se pjesëmarrja në parlament disa herë bëhet edhe obligim. Në takimet e hapura që i mbante çdo ditë të Enjte në shtëpinë e tij i parashtroheshin pyetje të ndryshme. Në takimin me nr. 210 i parashtrohet kjo pyetje: **Cila është dispozita fetare për votimet që bëhen në Kuvajt, duke e ditur se shumica e atyre islamistëve dhe thirrësve islamikë që janë futur në to janë sprovuar në fe?** Përgjigjja: Unë mendoj se votimet janë të detyrueshme dhe duhet të caktojmë një njeri që mendojmë se është i mirë, sepse po që se largohet njeriu i mirë nga ky vend, kush do të futet në atë vend? Të këqijtë, ose ata që janë negativë, ata që s’kanë as hair e as sherr, pasues i secilit zhurmmaxhi. Andaj ne duhet ta zgjedhim njërin prej nesh. **Mirëpo shumica e tyre nuk janë si ata?**, i themi: s’prish punë, ky njeri që është një, nëse Allahu i jep bereqet dhe e thotë fjalën e vërtetë në këtë vend, patjetër do të ketë ndikim, mirëpo na mungon vërtetësia me Allahun. Mbështetemi në gjërat materiale dhe nuk shikojmë fjalën e Allahut. Çka mund të thoni për Musain, alejhisselam, kur kërkoi nga ai takim për të sjellë magjistarët e tij. Musai, alejhisselam, i dha takim paraditen e ditës së stolisjes, d.m.th. ditë feste, sepse njerëzit stolisen ditën e

festës, në mes të ditës e jo natën, në një vend të lartë. U mblodh tërë bota, e u tha Musai, alejhisselam: **“Atëherë Musai u tha atyre (magjistarëve): “Mjerimi është juaji, prandaj mos shpifni ndaj Allahut ndonjë gënjeshtër e t’ju shkatërrojë me ndonjë dënim, se pa dyshim ai që shpif ka dështuar keq”.** (Taha: 61). Një fjalë u shndërrua në bombë. Allahu, subhanehu ve teala thotë: **“Ata (magjistarët) u përçanë mes vetes për çështjen e tyre, por bisedën e bënë fshehurazi (nga masa)”.** (Taha: 62)

Shkronja *fa* në këtë ajet ka për qëllim renditjen, pasimin dhe është për shkak të fjalimit të Musait, alejhisselam. Domethënë që nga momenti kur e tha Musai, alejhisselam, këtë fjalë ata u përçanë mes vete, e kur njerëzit përçahen mes vete, dështojnë, sikurse ka thënë Allahu, subhanehu ve teala: **“...e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake)...”.** (El-Enfal: 46). **“Ata (magjistarët) u përçanë mes vete për çështjen e tyre, por bisedën e bënë fshehurazi (nga masa)”.** (Taha: 62)

Rezultati ishte se magjistarët që erdhën të kundërshtojnë Musain, alejhisselam, u bënë me të, i ranë në sexhde Allahut dhe publikuan: **“...Ne i besuam Zotit të Harunit dhe të Musait!”** (Taha: 70). Faraoni ishte para tyre, mirëpo fjala e vërtetë të cilën e tha një njeri ndikoi te masa e madhe, lider i së cilës ishte qeveritari më zullumqar. Them: të supozojmë se parlamenti ka vetëm pak njerëz ithtarë të vërtetës dhe të saktës, ata do të bëjnë dobi, mirëpo ata duhet të jenë të sinqertë me Allahun. Atyre që thonë:

nuk lejohet hyrja në parlament sepse me këtë vepër përzihemi me njerëz të prishur, kurse ndenja me ta nuk lejohet, u themi: nuk ulemi me ta që të pajtohemi me ta, por për t’ua treguar të saktën. Disa vëllezër dijetarë kanë thënë: nuk lejohet pjesëmarrja në to (parlamente) sepse me këtë vepër përzihet njeriu i mirë me atë të devijuarin. Mirëpo pyesim: **ky njeri i mirë rri me të prishurin për ta përmirësuar ose për të devijuar vet?!** Ai rri me të për ta përmirësuar, dhe nëse nuk arrin sukses këtë radhë do të arrijë sukses radhën tjetër”. (shih: “Likau Babil-Meftuh”, nr. 210). Në vitin 1992 populli algjerian ish bërë gati për të hyrë në zgjedhje parlamentare, për këtë shkak myslimanët kishin dërguar një letër me gjashtë pyetje deri te Muhadithi i këtij shekulli, hoxha i madh, Muhamed Nasirudin Albani, rahimehullah, ku kërkonin përgjigje prej tij rreth lejimit apo moslejimit të pjesëmarrjes në votime. Ai, pasi tregon se parlamenti nuk është rruga për të sjellë ligjin e Allahut dhe se myslimanët duhet të punojnë gjatë kohë në udhëzimin e njerëzve me dije të saktë dhe edukim të mirëfilltë në këtë islam burimor, pastaj thotë: “Nuk shoh çka mund ta pengojë popullin mysliman, nëse si kandidat për deputet paraqitet një njeri që armiqëson fenë Islame dhe një tjetër që është islamist, prej partive me metoda të ndryshme, në kësi rasti këshillojmë secilin mysliman të votojë vetëm islamistët edhe ata që janë më afër metodës së saktë, të cilin e treguam më herët. E them këtë edhe pse besoj se votimi dhe zgjedhjet nuk e realizojnë qëllimin e synuar, sikurse treguam më herët,



mirëpo për të pakësuar të keqen dhe për të larguar një dëm më të madh duke bërë një dëm më të vogël, sikurse thonë fukahatë”. (shiko: “El-Asale”, nr. 4, fq. 20).

**Më lart përmendëm pikënisjet e dijetarëve islamë rreth kësaj çështjeje dhe disa qëndrime të dijetarëve bashkëkohorë rreth këtij problemi. Kurse në vijim do t’i përmendim dijetarët e umetit që kanë ndarë këtë qëndrim.**

1. Shejhul Islam Ibën Tejmju, rahimehullah, duke u mbështetur në kërkesën e Jusufit, alejhisselam, për t’u bërë ministër i financave në mbretërinë e Faraonit, në një shoqëri idhujtarësh, e cila nuk gjykonte me ligj të Allahut, argumentoi se lejohet marrja e pushtetit të përgjithshëm në një shtet zullumqar ose jobesimtar. Shih për këtë çështje librin “Mexhmuul-Fetava” vëllimi 14, faqe 493, vëllimin 15, faqe 324, vëllimin 20, faqe 56 dhe

faqe 148. Në këtë kontekst Shejhul Islami, rahimehullah, duke folur për këtë rast thotë: “Marrja e pushtetit mund të jetë e lejuar, e pëlqyer dhe e detyrueshme, mirëpo për ndonjë njeri të caktuar mund të jetë edhe më e detyrueshme dhe më e dashur, atëherë u jep përparësi më të mirës prej dy të mirave, disa herë si detyrim e disa herë si vepër e pëlqyer. Në këtë formë Jusufi, alejhisselam, mori përsipër depot e tokës për mbretin e Egjiptit, madje, edhe kërkoi që ta bëjë përgjegjës edhe pse ai dhe populli i tij ishin jobesimtar, sikurse e tregon këtë Allahu, subhanehu ve teal: *“Edhe Jusufi qysh herët ju pat ardhur me argumente të qarta e ju gjithnjë ishit në dyshim ndaj asaj që ju pat sjellë...”*. (Gafir: 34). *“O ju dy shokët e mi të burgut, a është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose Allahu, i vetmi ngadhënjimtar?” Ata që ju adhuronin përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që i pagëzuan ju dhe prindërit tuaj...”*. (Jusuf: 39-40).

Është e ditur se ata edhe pse kanë qenë jobesimtarë, domosdo kanë adete dhe zakone në marrjen e pasurisë dhe harxhimin e saj për kujdestarët e mbretit, familjen, ushtrinë dhe popullin e tij. Pa dyshim se ato adete dhe zakone nuk kanë qenë në përputhje me ato të pejgamberëve. Jusufi, alejhisselam, nuk mund të bënte të gjithë atë që do të dëshironte, ato pjesë që i shihte si pjesë e fesë së Allahut, sepse populli nuk do t’i përgjigjej atij, por bëri të mundshmen e drejtësisë dhe bamirësisë dhe me pushtetin e vet nderoi besimtarët nga familja e vet, gjëra që nuk do të mund

t'i kishte bërë pa këtë pushtet, kurse krejt kjo hyn brenda ajetit Kuranor: **“Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të Allahut...”**. (Et-Tegabun: 16).

Kur të shtyhen dy detyra (vaxhibe) dhe nuk mund të bashkohen, e i jepet përparësi më të sigurtës, tjetra në këtë rast nuk është detyrë dhe se ai që e le këtë detyrë për ta bërë më të sigurtën, në realitet nuk e ka lënë detyrën.

Kur të bashkohen dy ndalesa (haramet) dhe nuk mund ta lëmë më të madhen përpos duke e bërë më të voglën, në këtë rast bëra e ndalesës (haramit) më të vogël nuk është bërje e ndalesës në realitet edhe pse kjo vepër quhet lënie e detyrës (vaxhibit), kurse emërtimi i kësaj vepre ndalesë si emërtim absolut s'e dëmton aspak. Kjo thuhet edhe për lënien e detyrës (vaxhibit) për arsye dhe bërjen e ndalesës (haramit) për interes të sigurt ose për domosdoshmëri ose për të shtyrë atë që është më e ndaluar.

Kapitulli i kundërthënieve është një kapitull i gjerë, sidomos në kohërat dhe vendet ku janë pakësuar gjurmët e pejgamberisë dhe hilafetit të pejgamberisë. (“Mexhmuul-Fetava”, 20/57).

2- Këtë mendim kanë ndarë edhe mufesirët e njohur, siç është Ibën Atije, Zamahsheri, Bejdaviu, Shevkani, Kasimiu dhe Alusiu, të cilët në tefsiret e tyre kanë theksuar ligjshmërinë e pjesëmarrjes në pushtet jo islam, nëse kjo sjell interes të madh apo largon dëm të rrezikshëm, edhe nëse me këtë pjesëmarrje nuk arrijmë të bëjmë ndonjë ndryshim rrënjësor.

3- Imami i Nexhdit, Abdurahman Sadiu, rahimehullah, ka thënë se lejohet një gjë e tillë, madje, edhe detyrohet. (shih: “Tejsriul-Kerimir-Rahman”,

3/457).

4- Sultani i Dijetarëve, Iz b. AbduSelami ka thënë se një gjë e tillë është e ligjshme në librin “Kavaidul-Ahkam”, 1/73).

5- Po të njëjtën ka thënë edhe Ibën Abidini në librin “Hashijetu Ibën Abidin”, fq. 4/175).

6- Shejhu i madh Ibën Bazi, rahimehullah, ka dhënë feta se lejohet kjo gjë dhe se kjo e ndihmon të vërtetën dhe manifeston mospajtimin me të pavërtetën. (shiko: “Ed-Davetu ilallah ue Ahlakud Duati”, fq. 25).

7- Kësi fetva ka dhënë edhe dijetari i madh, komentuesi i të gjitha librave të akides, e sidomos të librave të shejhul Islam Ibën Tejmiut, Muhamed b. Salih elUtthejmini, rahimehullah.

8- Shejh Muhamed Emin Shenkiti ka qenë gjykatës në kohën e kolonializmit francez të Mauritanisë.

9- Shejh Albani, Muhadithi i Shamit, ka dhënë fetva se lejohet pjesëmarrja në votime për të pakësuar të keqen ose për të larguar një dëm më të madh duke e bërë një dëm më të vogël (shiko: “Hajatul Albani”, 1/395).

10- Shejh Abdurahman AbdulHalik e ka mbrojtur fuqishëm këtë qëndrim në disa libra të tij, prej tyre në librin “myslimanët dhe aktiviteti politik” dhe “Kapituj nga politika fetare gjatë thirrjes në fe të Allahut”.

11- Shejh Muhamed Salih Munexhidi ka të dhënë fetva për lejim të pjesëmarrjes në votime për të pakësuar të keqen dhe dëmin dhe se është çështje ixhtihadore që ka të bëjë me vlerësimin e interesit dhe dëmit.

12- Dr. AbdulKerim Zejdan, dijetar i madh i Irakut, ka dhënë fetva për lejim të pjesëmarrjes në votime.



13- Shejh Abdurahman Beraki. (mund ta lexosh te rubrika pyetje dhe pergjigje)

14- Shejh Nasir elOmer, shejh Selman Aude, shejh Sefer Havalı kanë thënë se lejohet votimi dhe se është një hap për të përforcuar shkaqet e përmirësimit dhe për të dobësuar shkaqet e prishjes dhe se sipas ligjit të zhvillimit do të shpien në përmirësimin e asaj që është më lartë, kurse qëndrimi anashkalues dhe refuzues nuk sjellë ndonjë përmirësim.

15- Dr. Jusuf Kardavi vlerëson se votimi është dëshmi të cilën myslimani duhet ta jep në formën më të mirë.

16- Omer Abdurahmani mendon se lejohet votimi dhe se ka shpresuar të merr pjesë në votimet për parlamentin egjiptian në vitin 1978. (Këtë e thotë dr. Harith Dari, kryetari i “komitetit të dijetarëve mysliman” në Irak gjatë elaborimit të pjesëmarrjes në votimet parlamentare irakiane).

17- Dr. Suud Funejsani, Abdullah Fekihu, Omer Eshkari, si dhe shumë dijetarë tjerë.

Është interesant të përmendim në këtë rast se edhe **“Ushtria Islame”** në Irak e cila reziston dhe lufton kundër forcave okupatore atje dhe **“Komiteti i dijetarëve myslimanë”** si përfaqësues të myslimanëve sunit të Irakut, kanë dhënë deklarata ku lejojnë pjesëmarrjen në votime dhe se kjo assesi nuk është kufër.

Madje edhe hoxha i disa njerëzve që merren me çështjet e tekfirit, Ebu Muhamed Makdisiu, kundërshton AbdulKadir AbdulAzizin<sup>1</sup>, i cili në librin e tij “El-Xhami” thotë se ata që votohen dhe ata që votojnë janë jobesimtarë,

duke thënë se duhet bërë dallim mes atyre që votohen dhe atyre që votojnë dhe se assesi nuk mund të trajtohen si kafira ata që votojnë dikë duke menduar se me këtë e ndihmojnë fenë e Allahut, subhanehu ve teala. (Shiko: “En-Nuketul-Levamiu”, fq. 21). Ky paragraf ishte vetëm si sqarim për një pjesë të vogël të njerëzve që kanë rënë nën ndikimin e këtyre muhabetëve edhe pse është jashtë analizës shkencore të këtyre meseleve.

### Për fund

Duke u nisur nga këto sqarime mendojmë se myslimanët e vendeve tona duhet të dalin masivisht në zgjedhje dhe të mos lejojnë që të manipulohet me votat e tyre, por ta shprehin mendimin dhe qëndrimin e tyre publikisht dhe haptazi se kush është e keqja më e vogël në mesin e popullit tonë dhe të dënohet ai i cili tallet me fenë tonë.

Dalja masive e popullatës tonë në votimet që mbahen anë e mbanë viseve tona do të jenë një shenjë e vigjilencës dhe korigjimit syçelë të gabimeve të atyre që i zgjedh populli për t'i përfaqësuar interesat e tyre nëpërmjet tyre.

Dalja masive e popullit tonë në votime, së paku për të bërë të pavlefshme fletët e votimit është një përgjigje aktive dhe shprehje konkrete e mospajtimit me mënyrën se si zhvillohen gjërat në vendin tonë. Kjo pa dyshim se është më mirë sesa mosdalja aspak në votime. Allahu u dhëntë sukses myslimanëve. Amin.

<sup>1</sup> Edhe pse ky njeri para disa muajve ka ndryshuar tërësisht qëndrimet e veta në lidhje me këto çështje që i ka promovuar në dy librat e tija “El-Xhami Fi talebil-Ilmi” dhe “El-Umde fi Idadil-Ude”. Përndryshe emir i vërtet i këtij është Sejid Fadl Imam dhe ka qenë teoreticenti kryesor i meseleve të tekfirit në organizatën “El-Xhihad” të Egjiptit.



# Mbrëmja e maturës - “Maturomania”

Shkruajnë: Almedina Dauti & Fitore Haziri

**P**o kthehesha nga shkolla për në shtëpi. Kishte rënë muzgu i mbrëmjes. Dielli kishte skuqur horizontin e dukej që kupa e qiellit do të merrte flakë. Majat e kodrave përshëndeteshin përfundimisht për atë ditë me rrezet e tij e qytetit i falnin hijen e tyre, për të paralajmëruar ardhjen e natës me terrin e zi.

Gumëzhinte rruga kryesore me trafik të dendur, dëgjohej sirena e ndonjë veture që trembte laraskat mbi degët e blirëve në trotuare; nguteshin njerëzit sikur të kishte ndodhur diçka e qendra i ngjante zgjoit të bletëve. Ajri ishte i lehtë si një vello që valëvitet me tundjen e së cilës prishej qetësia e gjetheve të drunjeve të

mbjellë përskaj rrugës.

Tërë asaj zhurme, dinamikë përbërëse e përditshmërisë së njerëzve, asaj tërësie të atij peizazhi të mbushur pluhur, asaj ngutje që ndjehej në ajër, asaj mërzie nga dita e gjatë e pranverës së hershme, i bashkëngjitej edhe zhurma e orëve të mësimi që kumbonte në mendjen time. Ishim tok të gjitha shoqet e nuk e di se si mbeta vetëm që të kthehesha në shtëpi. Mu kujtua biseda e fundit që kishim me njëra tjetrën e që pikë referuese kishte preokupimin tonë të fundit, “gajlen” më të madhe të këtij fundviti: **mbrëmjen e maturës**. Kishim të gjitha merakun se si do të kurorëzonim mbrëmjen e fundit së bashku... çfarë do të bënim diçka më speciale... diçka që nuk do ta harronim asnjëherë e do të mbetej në kujtesën tonë për një kohë të gjatë. Dëgjova aq shumë dëshira, aq shumë ide se si do të dukeshin shoqet atë mbrëmje, aq shumë shushurima e mosdurim për natën finale, silleshin e rrotulloheshin mendime nga më qesharaket e deri tek absurdi më i madh që kisha dëgjuar: që nga thjeshtësia si ide, e deri tek pamja e princeshës së përrallave... Ndërsa imagjinata ime lozte lojën më të pakuptueshme se si unë do të dukeshin, çfarë do të vishja, si do ta bëja grimin, si do t'i rregulloja flokët... si do të bëhesha e paharrueshme atë natë! Ku do të gjeja diçka që do të më bënte të veçantë vetëm mua?! Ku do të gjeja fustanin më të paparë deri atëherë? Ta blija këtu... jo në fakt nuk kisha shumë opsione! Ta porosisja nga jashtë përmes të afërmve të mi atje, apo të porosisja vetëm materialin e

mandej do ta qepja për qejfin tim... ndoshta kështu më mirë! Do të ishte mirë që t'i gjeja edhe sandalet e përshtatshme me take pakëz më solemne te veshura në elegancë. Nuk duhej të harroja që me kohë të bëja terminin tek parukieri, ashtu që të mos më paraqitej ndonjë problem në momentin e fundit. Me një fjalë duhej të mendoja për të gjitha, që kur të vinte dita vetëm t'i përmbahesha agjendës! U krijua një lëmsh mendimesh që nuk ua dija as fillin, derisa ecja me hapa të rënduar rrugës për në shtëpi. Dukej sikur nuk më bindeshin këmbët në drejtimin që unë urdhëroja të bënin ecejaket. Çanta në krahun tim rëndonte nga librat e nga gjysma e uniformës që tani ishte bërë zakon ta vishnim vetëm para hyrjes së shkollës. Era e lehtë m'i shprishte flokët e dukej sikur lozte lojën më të këndshme me to. Mendjen e kisha gjetiu tani... kur për një çast ndalova para një dyqani me xhama të tejdukshëm. Ndalova për të vetmen arsye: të shikoja panon (apo pllakatin) që e kishin vendosur nxënësit e njëres prej paraleleve të gjeneratës sime. Të radhitur ashtu me radhë... së pari dy nga profesorët, mandej kujdestari në ballë të panos... mandej nxënësit në çifte njëri pas tjetrit e mbulonin sipërfaqen e pllakatit të rrethuar e të stilizuar në mënyrën e ideatorit! Mu kujtua që klasa jonë ende nuk ishte gati me idenë se çfarë do të vishnim për t'u fotografuar ndërsa dizajni i pllakatit ishte gati dhe do të ishte më i veçanti në qytet. Isha humbur duke i shikuar ato fytyra të rregulluara e të nënshtruar “regjimit” të programeve

kompjuteristike, aq sa disa prej tyre nuk i njihja, aq shumë kishin ndryshuar!!! Isha habitur krejt fare, e ngujuar në një vend duke shikuar si e marrë gjithë atë ekspozim fytyrash, ndërsa rreth meje ishin grumbulluar gjithë ata njerëz me të vetmin qëllim që isha ndalë edhe unë. Dikush shikonte të birin, të bijën, dikush tjetër dikë që e njihje e dikush vetëm sa për kureshtje në mos e njihje ndokënd apo për të komentuar me të tjerët se cili/cila dukej më bukur... U largova ngadalë pa rënë në sy e me kokë të ulur duke u munduar të shpejtoja hapat për në shtëpi sepse nata vetëm kishte trokitur në nënqiellin e qytetit tim. Në tërë vrushkullin e mendimeve të përziera, në botën time pa kahe në ato momente, ndërhyri përshëndetja e një personi që e njoha vetëm përmes butësisë së zërit të tij. Kisha respekt të madh ndaj tij kështu që ndalova për pak minuta, i ndërruam dy tri fjalë rutinore përshëndetëse, për t'ia lënë vendin një bisede të shkurtër, aspak të zakonshme e shumë efektive në disa aspekte... me një tungjatjeta u ndamë e unë mbeta e shtanguar, e edhe më e hutuar se që isha. Për një çast mu duk se gjithë ai pluhur që qëndronte pezull në ajrin e atij mjedisit m'i kishte rënduar sytë e mi e nuk po shihja si duhet... tërë mjegull!!! Kisha thurur mendime nga më të ndryshmet e nuk isha e zonja ta pyesja veten se për çfarë arsye e gjithë kjo... Për çfarë arsye i kisha gjithë ato mendime, gjithë ato ide për finalizimin e atij fundviti... Për çfarë po përgatitesha? Për çfarë po e shpenzoja gjithë këtë kohë që më ishte

falur? Sa absurde dhe e pamenduar mirë: harxhoja kohë për të menduar... sigurisht relacioni shkollë-shtëpi kishte zgjatur më tepër se zakonisht, shumë më tepër! Do të harxhoja kohë për të gjetur dhe finalizuar gjithë idetë e mia për një pamje "perfekt", do të harxhoja paratë që prindërit e mi me aq mund i kishin fituar... dhe për çfarë? Për një natë... për një natë të vetme, diku rreth 9-10 orë gjurulldie të mbushur me marifetllëqe nga më të ndryshmet deri në zvetënim, të paraprirë nga sfilata nëpër rrugën kryesore të qytetit, përngjasim i ekspozimit të produkteve në panaire; e të tjerët përngjasim i blerësve, e në këtë rast: blerës pa monedha adekuate përveç kullotjes së syve me lakuriqësi. Natë ku të tjerët do të shikonin fustanin tim... trupin tim... flokët e mi të bukur... e fytyrën time të rregulluar enkas! Natë ku ashtu siç e quanim ne të fundit, unë e të gjithë të tjerët do të linim një imazh të fundit me pamjet tona, sjelljet tona tashmë nën ndikimin e muzikës shurdhuese, të qeshurat e pakontrolluara, vallet pa shikuar se me kë apo si... Vërtet të gjithë pjesëmarrësve të atij evenimenti final, do t'ju linim imazhin e "paharrueshëm", pamjen që aq shumë e kishim diskutuar, e që i kishim trazuar edhe njerëzit jo të afërt me familjen... Kjo në fakt do të ishte dëshira jonë... të mos harroheshim!! Të kujtoheshim pa menduar se si dhe në çfarë mënyre do të kujtoheshim! Kështu dëshironim të finalizonim 4 vite së bashku... 4 vite mund e sakrificë për të qenë më të suksesshëm e për të ecur sigurt... 4 vite përballje

me teket e të tjerëve për të mos mbajtur orë kur dëshironin ata... 4 vite mund e zell për t'ju ndihmuar atyre që kishin më shumë nevojë... 4 vite së bashku me udhërrëfyesit tanë - mësuesit tanë, do t'i finalizonim me të "paharrueshmet" veshjet tona, pamjet tona, e imazhin final përmes një nate të vetme... përmes disa orëve që do të kalonin sa hap e mbyll sytë për të lënë një vijë të gjatë e të kuqe, në plejadën e sukseseve për 4 vite!

Mbrëmja e maturës është kurorëzimi i përfundimit të viteve që i kalova në shkollë, tani po pyes veten çka realisht jam duke kurorëzuar unë? Apo po kurorëzoh për të rinjtë që erdhën si lule e çelur, u shoqëruan me lulet e vyshkura e me sytë e mi e pashë vyshkjen e tyre! Apo ndoshta po kurorëzoh ato ditë ku harruam qëllimin e ardhjes në shkollë e i lamë profesorët me ditar në duar në klasën e zbrazët ose më mirë doja të dukeshin më e bukura e mbrëmjes sepse nuk isha argëtuar mjaft?!

E tani? Çfarë po kurorëzohim... çfarë po kurorëzoja për të madhin Zot? Vyshkjen e luleve më të bukura që do të gjeje... zhgënjimin e profesorëve me ditar në duar sepse kishin gjetur klasën e zbrazët, sepse nxënësit kishin ikur për t'u fotografuar për pllakat.... apo se tash është fundi dhe kishim nevojë më shumë për të ikur se sa për të shijuar ditët e fundit në bankat që aq shumë kishin hequr prej nesh...? Kishim harruar

atë më të rëndësishmen: qëllimin e ardhjes sonë në atë institucion edukativo-arsimor emër ky i cili ka mbetur vetëm pjesë e emërtimit të objekteve me banka, tabela të zeza, mësues e me disa të rinj që e quajnë veten nxënës. Donim që gjithë këtë argëtim ta finalizonim me një mbrëmje të paharrueshme, sepse pak ishim argëtuar, sepse kishim ende nevojë për çorodi shtesë të paketuara edhe me natën e fundit së bashku! Kërkonim gjithë këto gjëra... harruam se të

**Mbrëmja e maturës është kurorëzimi i përfundimit të viteve që i kalova në shkollë, tani po pyes veten çka realisht jam duke kurorëzuar unë?**

gjithë kanë drejtuar sytë kah ne për të prituar dritë, rreze shprese për një të ardhme më të mirë, për një të ardhme ku në vend të darkës të mos shtronim lotët e trishtimin... të largonin angështimin nga zemrat e prindërve tanë me frikën se çka do të bëhej me ne... Harruam se jeta nuk mbaron me kaq, me një mbrëmje e disa orë argëtim... në fakt në perspektivën tjetër, për shumë kë me kaq do të mbaronte argëtimi e kënaqësia për t'ia lënë vendin dëshpërimit e humbjes në humnerën e lotëve, pa ditur se çka tutje...

Po e pyesja veten... po më silleshin vërdallë gjithë këto mendime. Ktheva kokën për të shikuar atë njeriun që ndërroi kahun e mendimeve të mia, që fshiu pluhurin nga sytë e mi, e shumë qetësisht sikur më tha: "Zgjoju, hap sytë! Shiko se si çdo ditë lind e perëndon... e ti fle... kërkon argëtim... kërkon shpërblim për rrugën tënde që ende është "nisur"... gëzoju dhe shfrytëzo çdo ditë deri në



atomin e fundit të energjisë... gëzoju dhe falënderohu që toka po të mban, që dielli me rrezet e tij përkëdhel flokët e tu e ngrohë edhe zemrën tënde, që qielli mban në jetë tokën e tharë me shiun që bie, që ti ende po frymon e po jeton e po furnizon barkun tënd me ushqim... e më thuaj a ka argëtim e kënaqësi më të madhe se sa të dish që ke dhe një mundësi që tani e tutje t'i gëzohesh lindjes së diellit se je GJALLË... e se besueshmëria se do të presësh muzgun e mbrëmjes është pashmangshmërisht e vogël...!"

Harruam se është koha kur para syve tanë është shfaqur udhëkryqi i të ardhmes tonë, e nuk ndjehet ajo fryma e kujdesit ndaj tij... nuk kemi menduar për kahun që do të marrim. Duhet t'i hapim sytë e t'i bëjmë katër... të largojmë gjumin nga sytë tanë... ta largojmë koten e të zgjohemi nga ëndrrat e absurdit, e t'i japim ngjyrim tjetër jetës sonë. Mos të lejojmë të përkundemi në iluzione e përsiatje të gjërave të kota, të mendojmë atë që është kapitale, e të bëjmë binarë të fortë që treni të mos devijojë nga rruga që kemi nisur. Të mos lejojmë që velat e anijes tonë të shqyhen nga axhamillëku e pakujdesia që kemi, mos të lejojmë të fundoset ajo në detin e paanë të jetës e të përлахet nga grabitqarët e pamëshirshëm të unët për të ngrënë çdo gjë që ju serviret...



# KTHIMI I FUNDIT

**Muhammed Sherif**

**N**ë vazhdim do të shpalojmë letrën e Policisë dërguar një Dijetari Islam, i cili përveç përshtimeve të ndodhive, kishte shtuar se ato ishin bërë shkaktar kryesor që ai t'i kthehet rrugës së Allahut.



Në letrën e tij kishte thënë: Shikimi i aksidenteve të ndryshme dhe viktimat e përfshira ishin gjëra të zakonshme në jetën time të përditshme, mirëpo një incident ishte krejtësisht i ndryshëm dhe dallonte nga të tjerët.

### Ngjarja e parë

Unë dhe kolegu im kishim ndalur veturën në trotuarin e magjistrales, ku bisedonim për një çështje, papritmas, në të qindtën e sekondës, vendi mori një pamje të tmerrshme, zhurma e dy veturave u dëgjua dhe u bënë sikur të ishin një. Ne pamë pas se çfarë po ndodhte; ish një aksident i paparë, dy vetura ishin ndeshur njëra me tjetrën. Si shkak i aksidentit ishte rrëshqitja e automjetit ku rezultoi në humbjen e drejtimit dhe më pas qe përplasur në veturën që ishte duke

ardhur në drejtim të tij. Nuk do të kishit mundur ta përshkruani se çfarë kërde kishte ngjarë.

Në veturën e parë gjendeshin dy djem të shtrirë për së gjati, që të dy në gjendje kritike. Me kujdes i tërhoqëm nga vetura dhe i vendosëm në tokë në mënyrë që të kthjelloshin nga ajo përplasje e tmerrshme. Me shpejtësi u kthyem t'i ofronim ndihmë pronarit të veturës së dytë, mirëpo ai kishte ndërruar jetë. Më pas nxituam tek dy djemtë e ri, të shtrirë krah për krah njëri-tjetrit, në trotuarin e autostradës. Shoku im filloi t'u përmendte shehadetin: *"La ilahe il-Allah - Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut."* Ajo që më hutoi ish se gjuhët e tyre nuk e pranoinin këtë dëshmi. Në fakt ata filluan të zukatin duke kënduar disa tekste këngësh. Unë u tmerrova nga kjo pamje,

megjithatë shoku im kishte përvojë dhe vazhdonte në përsëritjen e shehadetit “La Ilaha il-Allah”. Unë qëndroja në këmbë duke parë me ngulm, pasagjeri nuk lëvizte, qëndronte symbyllur. Asnjëherë në jetën time nuk kisha parë diçka të ngjashme me atë që sot dëshmonin sytë e mi.

Në të vërtetë, kurrë në jetën time nuk kam parë ndokënd duke ndërruar jetë, e aq më pak në atë mënyrë djallëzore. Shoku im vazhdonte duke u përmendur atyre shehadetin, mirëpo ajo nuk kish efekt, pasi gumëzhima e këngëve të tyre vinte duke u zvogëluar dalëngadalë, i pari vdiq, e më pas edhe i dyti. Ia dorëzuan Allahut shpirtin dhe u larguan nga kjo botë. Pasi ata ndërruan jetë, i morëm dhe i dërguam në veturën tonë. Shoku im nuk tentonte të fliste, asnjë pëshpëritje nuk bëme derisa i sollëm kufomat në spitalin më të afërm.

### **Ngjarja e dytë**

Polici iu kthye detyrës së tij të mëparshme si polic patrullues, mirëpo një ditë prej ditësh, një aksident tjetër kishte zënë vend, si rrjedhojë, e kishte shtyrë policin t’i kthehej Zotit të Madhërishëm. Në letrën e tij dërguar dijetarit, thotë: Sa e çuditshme qenka kjo botë. Pas gjashtë muajve, një aksident tjetër trafiku kish ndodhur diku tjetër. Një djalosh i ri drejtonte veturën e tij me maturi, mirëpo në njërin prej tuneleve që shpinin për në qytet, ai ish detyruar të ndalë veturën për shkak të gomës së shfryrë të automjetit. Në anën e tunelit kish ndalur

veturën dhe ishte vendosur prapa saj ku po ndërronte gomën. Fishkëllima e një veture të shpejtë nga mbrapa në sekondë u përplas në veturën e ndalur të këtij djaloshi. Pronari i veturës së ndalur kishte qenë në mes të dy veturave ku kishte mbetur i shtrirë për tokë me lëndime serioze, në fakt ai ishte në rrezik jete. Unë nxitova te vendngjarja, gjithashtu edhe shoku im dhe arritëm aty. Së bashku e bartëm djaloshin në veturën e policisë dhe telefonuam spitalin që të përgatiten për rastin në fjalë. Ai ishte një djalë i rritur, në vitet e lulëzimit, ishte një besimtar i mirë, kjo dukej edhe nga ana e jashtme e tij. Derisa ne po e bartnim, ai lëvizte buzët e tij, mirëpo ishim në nxitim dhe nuk i kushtonim vëmendje se çfarë thoshte. Megjithatë, kur e vendosëm atë në shpinë dhe e dërguam në veturën e policisë, kuptuam se çfarë thoshte. Përgjatë dhimbjeve zemra e tij këndonte Kur’an! Ai ishte shumë i thelluar në leximin dhe këndimin e Kur’anit.

Nderimet i takojnë vetëm Allahut të Madhërishëm, ju asnjëherë nuk do të kishit mundur të thoshit se ky person ndjente dhimbje të mëdha! Gjaku i skuqur kishte depërtuar në tërë rrobat dhe ishte gjakosur në tërësi. Eshtrat e tij ishin thyer dhe dukeshin qartë në disa pjesë të trupit të tij. Me thënë të vërtetën, ai dukej sikur kishte parë vdekjen me sy. Ai vazhdimisht lexonte Kur’an me leximin e tij të veçantë, me një zë të ëmbël dhe të dhimbshëm, duke kënduar çdo ajet të Kur’anit me një ritëm të përshtatshëm. Do të thosha

se asnjëherë në jetën time nuk kam dëgjuar një këndim të tillë të Kur'anit. Thashë në vete: do t'i përmend shehadetin, pasi kështu veproi kolegu im më parë. Me kureshtje dëgjonim atë zë të butë dhe të ëmbël, ndihesha sikur një s'qethje më kishte kapluar dhe qimet e duarve ishin ngritur lart, papritmas, pëshpëritjet e tij morën fund. Unë në heshtje shikoja se si dora e tij u ngrit lart. Dëshmoi me gishtin e tij duke e ngritur në drejtim të qiellit dhe duke dëshmuar: "La ilahe il-lAllah - Nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut", më pas koka e tij ra në tokë ndjeshëm. Unë kërceva në ulëset e prapme te veturës që t'i verifikoj duart, zemrën, dhe frymëmarrjen e tij, mirëpo çdo gjë kishte marrë fund. Nuk ndalesha së vështruar gjendjen e këtij djaloshi. Një lot me ra nga syri dhe e fsheha që shoku im mos ta shihte. U ktheva te kolegu im dhe i thashë se djaloshi kishte ndër-ruar jetë. Ai kur dëgjoji këtë lajm ia plasi vajit zëshëm. Unë shihja shokun tim duke qarë dhe nuk munda ta kontrolloj veten time.

Brenda në veturë mbretëronte një atmosferë e mërzitshme nga të qarët. Arritëm në spital, nxitonim nëpër korridoret e tij duke shpejtuar të arrijmë në sallën e përgatitur për këtë djalosh. I rrëfyem mjekëve, infermiereve dhe të pranishmëve se çfarë kishte ndodhur më këtë besimtar te ri. Shumë njerëz u emocionuan nga ajo që rrëfyem, disa mbetën pa gojë dhe të përplotur nga ajo që panë dhe dëgjuan. Asnjëri nga të pranishmit nuk dëshironte të largohej para

se të mësonin mbi detajet se në ç'orë do të bëhej varrimi i tij dhe në cilin vend, kështu që ndjenin përgjegjësi t'i falnin namazin këtij besimtar te ri, gjegjësisht namazin e xhenazes. Pasi hasëm në dokumentacionin e tij, stafi i spitalit i bëri një telefonatë të shpejtë familjes se djaloshit, ata s'ishin në dijeni të aksidentit. Në telefon u përgjigj vëllai i të ndjerit dhe u informua për atë që kish ndodhur. Vëllai i tij na rrëfeu gjerësisht, duke thënë: Çdo të hënë, ai do të vizitonte gjyshen e tij, e cila banonte jashtë qytetit. Sa herë që ai i bënte vizitë gjyshes së tij, gjente kohë edhe për disa fëmijë të varfër, të cilët e humbnin kohën në rrugë, dhe po ashtu shpenzonte kohë edhe për jetimët. Atë e njihte i tërë qyteti, ishte një njeri që u sillte libra fetare dhe kasete me ligjërata dhe derse të ndryshme islame. Mazda e përhimët e tij, gjithherë ishte e mbushur me oriz dhe sheqer, madje, edhe bonbone për fëmijë, nuk harronte të sillte karamеле për fëmijët që kishin nevojë. Ai asnjëherë nuk priste që dikush ta dëshpëronte nga ai udhëtim i gjatë dhe i lodhshëm deri tek ai qytet ku banonte gjyshja e tij. Ai gjithherë përgjigjej me finesë duke shtuar se, udhëtimi i gjatë i ofronte kohë të përsëriste Kur'anin dhe njëherësh të dëgjonte ligjërata islame nga kasetat që kish në veturën e tij. Në këtë mënyrë, ai shpresonte së çdo hap drejt atij qyteti, do të ketë shpërbllim nga i Madhi Allah.

Vëllezër e motra, është e vërtetë se Allahu është i Mëshirshëm dhe Falës i mëkateve. Allahu i Plotfuqishëm, në

Kur'anin e Tij famëlartë thotë: *“Dhe vërtetë që Unë jam gjithnjë Falës i Madh për atë që pendohet, që beson (në Mua dhe nuk më vë shok në adhurim Mua) dhe që punon mirësi e drejtësi dhe pastaj u qëndron këtyre (deri në vdekje) (Ta – Ha, ajeti 82). Në një varg tjetër Kur'anor Allahu thotë: “O populli ynë! Përgjigjuni (me bindje) Thirrësit të Allahut (të Dërguarit të Allahut, Muhamedit) dhe besojeni atë (besoni në atë që ai ka sjellë prej Allahut dhe ndiqeni atë). Ai (Allahu) do t'jua falë juve gjynahet tuaja dhe do t'ju shpëtojë nga ndëshkimi I dhimbshëm (i Xhehenemit). (El- Ahkaf, ajeti 31).*

Kjo është e ngjashme me atë, kur dikush na telefonon dhe ne i përgjigjemi thirrjes së tij, pra kjo është thirrja e Allahut, dhe e Muhamedit, salallahu alejhi ue selem! Ejani t'i përgjigjemi thirrjes së Tyre. Në Kur'anin Famëlartë është një ajet Kur'anor, kur shejtani e lexon atë, qan dhe dëshpërohet, lexojeni këtë ajet se më të vërtetë është dera e lumturisë sonë në këtë dhe botën tjetër, thotë Allahu: *“Dhe ata të cilët kur kanë bërë zina (imoralitet) apo që e kanë njollësuar veten me gjynah, e kujtojnë Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre – dhe kush mund të falë gjynahet përveç Allahut? – dhe nuk vazhdojnë në gabimin që kanë bërë, kur e dinë atë. Për të tillët shpërblimi është Falje nga Zoti i tyre dhe Kopshte me lumenj që rrjedhin poshtë tyre për të banuar ndër to përgjithmonë. Sa i*

*shkëlqyer është ky shpërblim për punuesit” (Ali Imran, ajeti 135- 136).*

Allahu i Madhërishëm ka dërguar Pejgamber dhe Libra, Ai ka dërguar Qortues dhe Përkujtues, e mbi të gjitha Allahu, zbret në qiellin e kësaj dynjaje atëherë kur njerëzit janë duke fjetur, gjegjësisht në pjesën e tretë të natës, në mënyrën më të përshtatshme të Madhërisë së Tij. Allahu i Plotfuqishëm zbret për çdo natë, ku dhe kërkon prej çdo robi të Tij: *“A ka ndokush që më lutet mua e unë do të ia pranoj lutjen (duan) e tij? A ka ndokush që kërkon falje e unë do të ia falë atij? Pra, kjo është koha më e përshtatshme për të falur namaz vullnetar; për të bërë ibadet, për të kërkuar falje nga Krijuesi, i Cili pret lutjet e robit. Pra kjo është koha kur përderisa ti fal namaz, të tjerët janë duke fjetur.*

Të nderuar vëllezër e motra, ejani të zotohemi sonte mbrëma, ta kurdisim orën dhe të zgjohemi në ora dy të mëngjesit. Të gjithë e dimë se nëse ka sport special gjatë natës, apo dikush ka fluturim në atë kohë, vërtet do të jenë në gjendje të qëndrojnë pa gjumë vetëm e vetëm që të zënë fluturimin në kohën e duhur. Ejani ta kurdisim orën dhe t'i falim dy rekate për Allahun, dhe në sexhde të kujtojmë një mëkat që kemi bërë, vetëm një, pasi rënia jote në sexhde të qas afër Allahut, andaj dhe ta lusim Atë që të na e falë dhe të zotohemi që mos t'i kthehemi atij mëkati asnjëherë.

*Nga gjuha angleze:  
Feim DRAGUSHA*



**Shkruan: Besnik Pajaziti**

**A**rdhmëria, ky nocion shumë i rëndësishëm për çdo njeri të çdo kohe, e sidomos për njeriun bashkëkohor meriton të trajtohet në shumë fusha të dijes sepse është alfa dhe omega e çdo veprimtarie të tij. Ajo trajtohet përgjithësisht si një kategori dialektike e natyrës që e shpie njeriun kah veprimtaria e përditshme me vetëdije apo pa të, ajo madje ndonjëherë e gëzon njeriun e ndonjëherë e hidhëron, thënë shkurt është e lidhur

ngushtë me fatin e njeriut si qenie biopsiko-sociale.

Populli ka thënë “Ç’të mbjellësh do të korrësh”, prandaj duhet t’i kushtojmë rëndësi tejet të jashtëzakonshme kësaj kategorie, sepse po gabuam sot, do ta vuajmë nesër, pra e ardhmja ndërtohet sot.

S’ka dyshim që kjo kategori ka nevojë të trajtohet në shumë aspekte, siç thamë më lart, pra lidhet dhe është



Artikuj

bisedë shkak për çdo njeri të çdo moshe dhe në çdo punë bën pjesë.

Ardhmëria mund të lidhet me disa fenomene të kohës siç janë: transporti, shëndeti, kompjuterët, ekologjia, robotët, klonimi, por edhe sfera e besimit të njeriut, sepse tek e fundit këto që i përmendëm të lidhin vetëm në të ardhmen e kësaj bote, ndërsa besimi të lidhë me të ardhmen edhe të botës tjetër.

### **E ardhmja dhe shëndeti**

Këto dy fenomene të komplikuar, të ndërlidhur, e ndonjëherë kontradiktorë dhe në kontrast mes vetes duhet të trajtohen në nivele më të larta shkencore. Mirëpo mund të themi se shëndeti i njeriut me të vërtetë është shumë i lidhur me të ardhmen. Pa shëndet të mirë nuk ke të ardhme të mirë.

Nëse shohim arritjet mjekësore, mund të themi se ardhmëria e njeriut është përmirësuar falë tyre, përsosjes së mjeteve mjekësore tekniko-teknologjike; mirëpo, përmbajtja jo efektive e prodhimeve farmaceutike e bën ardhmërinë njerëzore të paqëndrueshme, duke e lënë shpesh në një qorrsoak.

Këtu duhet të cekim edhe politikat bio-etike të disa shteteve, ku në përgjithësi bio-organizmi njerëzor nuk po i kontribuon ardhmërisë njerëzore.

### **E ardhmja dhe familja**

Familja pa dyshim është shtylla e shoqërisë, celula dhe embrioni i saj, është themeli i një populli dhe një shteti. Këto dy nocione dhe fenomene janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin,

janë ngushtësisht të lidhur dhe potencialisht premtues për një jetë më të mirë. Ato janë baza e një fenomeni që quhet jetë, e pa të cilën pa dyshim s'ka ardhmëri.

Familja dhe ardhmëria për njeriun mbajnë peshë të madhe, pasi pa familje të shëndoshë dhe të qëndrueshme pa dyshim s'mund të ketë edhe ardhmëri, ndërsa e ardhmja është baza ku merr frymë shoqëria dhe familja.

Si institucion shoqëror, familja është vlera dhe simboli i së ardhmes, vullë dhe shenjë e saj domethënëse dhe thelbësore.

### **E ardhmja dhe besimi**

Për njeriun bashkëkohor, besimi si një kategori dialektike-natyrore dhe shoqërore është shpirti dhe fryma e së ardhmes. Pa besim, e sidomos të shëndoshë, nuk kemi edhe ardhmëri premtuese dhe të qëndrueshme.

Njeriu pa besim është gjysmë kafshë orale natyrore, që sillet dhe jeton sipas rastit dhe unit të tij shtazarak, madje bie në një gradë edhe më të ulët sesa kafshët, duke bërë vepra të ndryshme, siç është fenomeni i homoseksualizmit, që as kafshët nuk e bëjnë.

Pra, përfundimisht besimi është garantuesi më i mirë i të ardhmes në të gjitha aspektet, si në atë individual, familjar, shoqëror dhe shtetëror.

*(autori është student në Fakultetin e Evropës Jug-Lindore, Administrim Biznesi, Tetovë)*



# Allahu nuk ka nevojë për njerëzit, atëherë, pse jemi krijuar?

**Abdur Rahman b. Nasir El Ber-rak**

**I** falënderuar qoftë i Vetmi që meriton të adhurohet, salavatet dhe selamet qofshin mbi atë pas të cilit nuk do të vijë i dërguar tjetër prej Allahut.

Allahu, subhanehu ve teala, na ka

njoftuar me urtësinë e krijimit të qiejve dhe tokës, dhe krijimin e asaj që është mbi tokë, si dhe me urtësinë e krijimit të jetës dhe vdekjes. Urtësia është provimi i njerëzve dhe xhinëve. I Lartësuar i në librin e tij

**Temu**



me të cilin i ka sfiduar njerëzimin dhe botën e xhinëve, thotë: *“Ai është i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditëve (fazave), e Arshi (Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë, që t’ju sprovovë, se cili prej jush është më vepërmirë.”* (Hud, 7);

*“Gjithçka që është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t’i provuar ata, se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë.”* (El Kehf, 7); *“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënyyesi, Mëkatfalësi.”* (El Mulk, 2)

Nga ajetet e cekura u kuptua se Allahu, subhanehu ve te’ala, parim-

**Allahu, subhanehu ve teala, na ka njoftuar me urtësinë e krijimit të qiejve dhe tokës, dhe krijimin e asaj që është mbi tokë, si dhe me urtësinë e krijimit të jetës dhe vdekjes.**

isht, çdo gjë ka krijuar për të sprovuar njerëzit dhe xhinët dhe për të nxjerr në pah vepërmirët dhe mohuesit. Këtë gjë na e vërteton edhe realiteti i dukshëm, për të cilin Allahu në Kur’an pohon se të gjitha mirësitë dhe fatkeqësitë e kanë urtësinë e njëjtë, janë sprovë

për të obliguarit me detyrime fetare (el mukel-lefin). Në disa vende Allahu përdor fjalën *fitneh*: *“Ne, në shenjë sprove ju sprovovmë me vështirësi e kënaqësi, dhe ju ktheheni te Ne”* (El Enbija, 35); *“Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithqysh do t’i dallojë ata që e thanë të vërtetën e do t’i dallojë edhe gën-*

*jeshtarët.*" (El Ankebut, 2).

Me këtë sprovë dalin në shesh ata që thanë të vërtetën dhe gënjeshtarët, besimtari dhe mohuesi, fakte që Allahu i di para se të zënë vend në realitetin e dukshëm. Në një ajet të tjetër nga Kur'ani, Allahu, subhanehu ve te'ala, na tregon se qëllimi i krijimit të njerëzve është që ata të jenë vazhdimisht në kundërshtime dhe kështu të dallohen besimtarët dhe mosbesimtarët dhe si pasojë e këtyre kundërshtimeve realizohet sprovimi i njërit grup me të tjetrin: *"Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete), Përveç atij që e mëshiroi Zoti yt. Po për këtë edhe i krijoi ata."* (Hud, 118-119); *"Kështu Ne i sprovovmë disa me disa të tjerë ashtu që të thonë: "A këta janë mes nesh që Allahu i dhuroi? A nuk është Allahu më i dijsmi për ata që janë mirënjohës?!"* (El En'am, 53); *"Kështu pra, po sikur të dojë Allahu, Ai do të hakmerrej ndaj tyre, por Ai dëshiron t'ju sprovovë njërin me tjetrin. E ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, atyre kurrsesi nuk ua humb veprat (por ua shton)."* (Muhammed, 4).

I Gjithëfuqishmi, gjithashtu tregon se urtësia e luftërave që ndodhin mes besimtarëve dhe atyre që nuk besojnë është ndërrimi i ditëve (të fitores dhe

**Allahu do që robërit e Tij ta adhurojnë, të zbatojnë obligimet e Tij, ta shprehin dashurinë që kanë për krijuesin e tyre si dhe nevojën që kanë për Allahun.**

humbjes, të sundimit dhe të qenit i sunduar): *"Ne, këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) mes njerëzve për t'u ditur tek Allahu ata që besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë (ose dëshmues). Allahu nuk i do zullumqarët."* (Ali Imran, 140). Ajeti: *"Unë*

*nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë."* (Edh Dharijat, 56) kështu është komentuar nga dijetarët: Që t'i urdhëroj, ndaloj dhe të jem i adhuruari i tyre. Urdhrat dhe ndalimet e Allahut kanë qenë obligimet me të cilat janë dërguar pejgamberët e tij dhe ato vetvetiu janë sprovë për robërit, kriteri i dallimit mes të mirëve dhe të ligjve. *"Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t'u shpjegojë atyre (në atë gjuhë). E Allahu e lë të humbur atë që do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do. Ai është i fuqishmi, i urti."* (Ibrahim, 4); *"Allahu nuk është që t'i lë besimtarët ashtu siç jeni, pa dalluar të keqin nga i miri. Allahu nuk ju zbulon juve të fshehtat (e të dini se ç'mbajnë në zemrat e tyre). Por Allahu është Ai që nga të dërguarit e vet zgjedh atë që do (e i zbulon ndonjë të fshehtë). Prandaj, besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij, e në i besofshit dhe nëse ruheni, atëherë ju keni një shpërblim të madh."* (Ali Imran, 179).



Urtësi tjetër, nga krijimi i qiejve dhe tokës, të cilën Allahu, subhanehu ve te'ala, na e tregon në Kur'an është që robërit të njohin dijen e plotë të Allahut dhe fuqinë e tij të pakufishme: **“Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej dhe prej tokës aq sa ata; në to zbatohet vendimi i Tij për ta ditur ju se Allahu ka fuqi për çdo send dhe që me të vërtetë Allahu ka përfshirë çdo send me dijen e vet.”** (Et Talak, 12).

Allahu nuk e ka krijuar Ademin, xhinët dhe njerëzit sepse kishte nevojë për ta, ose sepse kishte nevojë për adhurimin e tyre. Allahu nuk ka nevojë as për adhurimin e melekëve, sepse është më i pasuri dhe nuk i nevojitet asgjë. Allahu do që robërit e Tij ta adhurojnë, të zbatojnë obligimet e Tij, ta shprehin dashurinë që kanë për krijuesin e tyre si dhe nevojën që kanë për Allahun. Dobia në këto raste kthehet vetëm tek njerëzit dhe xhinët, Allahu nuk ka asnjë dobi e as që ka nevojë për adhurimin e tyre.

Në një hadith kudsij thuhet: *O robërit e Mi! Ju kurrë nuk mund të arrini tek ajo, me çka Mua dëm do të Më shkaktonit që të Më dëmtonit, as që do të arrini ndonjëherë tek ajo që Mua dobi do të Më sjellë, që të Më kontribuonit; O robërit e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinët nga ju të ishin të devotshëm sikur zemra më e devotshme e njerit nga ju, kjo nuk do ta shtonte sundimin Tim në asgjë; O robërit e Mi! Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinët nga ju të ishin të prishur si zemra më e prishur e njerit nga ju, kjo nuk do ta mungonte sundimin Tim në asgjë; O robërit e Mi!*

*Sikur i pari nga ju dhe i fundit nga ju dhe njerëzit nga ju dhe xhinët nga ju të ngriheshit (qëndronit) në një vend dhe dëshirat dhe lutjet Mua të m'i drejtoni, dhe Unë t'i përgjigjesha lutjes së çdonjërit, kjo nuk do ta mungonte atë që kam Unë as aq sa që e mungon gjilpëra detin kur të futet në të.* (Muslimi, 2577).

Nëse dikush pyet: Nëse e dimë që melekët e kanë adhuruar Allahun para se të krijohen njerëzit, atëherë pse janë krijuar njerëzit?

Përgjigjen e kemi në ajetin vijues: **“(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!” Ata thanë: “A do të vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjak, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!”** Fjala e Allahut: “Unë di atë që ju nuk e dini!” nënkupton se krijimi i Ademit dhe përcaktimi i tij si mëkëmbës në tokë e ka urtësinë e vet, edhe pse nga disa pasardhës të tij do të ndodhin çrregullime në tokë dhe gjakderdhje.

Nga e përmendura më lart del në shesh se si pohimi se adhurimi është i vetmi qëllim për të cilin Allahu i ka krijuar njerëzit është i mangët. Qëllime të tjera krahas adhurimit, janë edhe sprovimi i njerëzve me sprova të ndryshme, njohja e Allahut, e emrave dhe cilësive të Krijuesit të lavdëruar. Allahut i takon dija absolute.

**Përktheu: Talha KURTISHI**

# Kamata dhe historiku i saj

Shkruan: Alaudin Abazi

## **Kamata në kohërat e lashta:**

Koncepti i kamatës ka një histori mjaft të lashtë; e veçanta e saj është se shkrimet e para vërtetojnë se ajo konsiderohej e urryer dhe e keqe. Ndoshta citati më i vjetër i shkruar për ndalimin e kamatës dhe trajtimit të saj si vepër e shëmtuar është ajo e kohës së faraonëve; **legjislacioni i faraonit Buhures** nga familja e njëzet e katërt e faraonëve.(1)

Trajtimi i kamatës si gjë e keqe përcillet edhe nga shumë filozof të



vjetër. Vërtetohet se teoreticenti dhe oratori i shquar romak **Marcus Tullius Cicero** e kishte ndaluar kamatën në shkrimet e tij. Gjithashtu edhe filozofët e vjetër grekë si **Platoni**, te libri **“Republika”**, dhe **Aristoteli**, te **“Politika”**, e ndalojnë marrjen e kamatës.(2)

### **Kamata në fenë Hebraike:**

Kamata ish e ndaluar dhe e papranueshme edhe në fenë hebraike, sikundërse ish edhe në atë të krishterë. Kjo vërtetohet në librat e mëhershme të shpallura si në Tevrat (Dhiata e vjetër) dhe në Ingjil (Dhiata e re). Por çifutët (hebrenjtë), pas të dërguarit Musa (alejhi selam) e lejuan marrjen e kamatës nga jo çifutët, duke pretenduar se pasuria e jo çifutëve është e lejuar për ta. Dihet se besimi hebre është i ndërtuar në parimin se populli hebre është populli i zgjedhur, prandaj ata kanë përparësi dhe vlerë ndaj të gjithë popujve të tjerë. Kështu që njerëzit e tjerë që janë jo hebrenj i trajtojnë si më të ultë, më të pavlerë dhe ata kanë të drejtë të manipulojnë me ta si të duan. Allahu i Lartësuar në Kur'an përcjell pretendimin e tyre: **“Ata (Ehlu Kitabi, pasuesit e librit) thoshin: “Ne nuk kemi kurrfarë përgjegjësie ndaj (pasurisë që u marrim) të paditurve (të tjerëve)”** (Suretu Ale Imran, 75).

Ajeti tregon se si çifutët i trajtonin të tjerët që nuk ishin si ata (pra, i quanin të paditur). Edhe çifutët që jetonin në Medinë gjatë kohës së

**Bota e krishterë ka vazhduar për një kohë të gjatë t'i urrejë dhe t'i diskreditojë çifutët për marrje të kamatës.**

Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, njiheshin për intriga dhe keqpërdorime të ndryshme duke u bazuar me këtë parim të tyre. Prandaj vërtetohet se ata me këtë pretendim, ia lejonin vetes të manipulonin me çfarëdo forme dhe pune për të marrë

pasuritë e të tjerëve që nuk ishin çifutë në Medinë.

Në kohën bashkëkohore vërehet edhe më qartë dominimi të cilin e kanë arritur me intriga të këtilla, derisa janë ngritur mbi shtetet më të fuqishme të botës. Mësimet çifute rreth superioritetit të popullit të tyre ndaj të tjerëve dhe trajtimi i të gjitha nacionalitete tjera të jenë në shërbim të tyre, nuk është një shpifje apo reflektim i urrejtjes ndaj tyre, por është një realitet që mbështetet në citatet e shumta në Talmundin e tyre.(3) Prandaj edhe reagimet dhe akuzat e çifutëve (se ai që flet për këto gjëra është antisemitist) është shumë i madh, pasi i bën të identifikohen realisht ashtu si janë. Në Talmund vërtetohet qartë se u lejohet marrja e kamatës nga jo çifutët. Allahu i Lartësuar i kritikon hebrenjtë për këtë pretendim dhe u tërheq vërejtjen se për këtë i pret dënim i rëndë: **“Dhe për shkak të mizorisë së atyre që ishin jahudi (hebrenj) dhe për shkak se penguan shumë nga rruga e Allahut, Ne ua ndaluam (ua bëmë haram) disa (lloje ushqimesh) të mira që u ishin të lejuara, për shkak të marrjes së**

kamatës, edhe pse e kishin të ndaluar atë, dhe ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë. Ne kemi përgatitur dënim të mundimshëm për ata që nuk besuan prej tyre.” (Nisa, 160-161). Kamata të cilën e merrnin çifutët nga të tjerët ish shtesa që merrnin nga jo çifutët, të cilëve u jepnin pasuri në hua. Kjo shtesë ish si rezultat i pritjes së kthimit të borxhit. Kjo formë e punës është mjaft e përhapur në kohën bashkëkohore vetëm se janë shpikur metoda të ndryshme; edhe pse emërtohen me emra të tjerë, esencën e kanë nga kjo formë e hershme e njohur te njerëzit.

#### **Kamata në fenë e Krishterë:**

Edhe në krishterim kamata trajtohet si e ndaluar dhe e urryer. Në Dhiatën e re kemi disa citate që vërtetojnë ndalimin e kamatës.(4) Gjithashtu ndalimin e kamatës e vërtetojnë shumë njerëz të krishterimit, sikurse Toma Akuini (1225-1274); pastaj, edhe Martin Luteri (themeluesi i protestantizmit) dhe shumë të tjerë,(5) sa që Skopari i krishterë thekson: “Kush thotë se kamata nuk është mëkat llogaritet dezertor dhe ka dalë prej fesë6”, që do të thotë se ka dalë prej fesë së krishterë.

Bota e krishterë ka vazhduar për një kohë të gjatë t’i urrejë dhe t’i diskreditojë çifutët për marrje të kamatës. Këtë e vërteton edhe shfaqja teatrale e Uilliam Shekspirin “**The Merchant of Venice**”, “**Tregtari i Venedikut**”, të cilin e ka shkruar viteve 1596-1598. Në këtë shfaqje bëhet fjalë për një çifut fajdexhi që quhet **Shylock**. Karakteri i këtij per-

sonazhi çifut është mjaft diskreditues, pasi paraqitet nënçmues dhe neveritës ndaj borxhliut nevojtar, të cilit i jep hua me kamatë. Shekspiri me anë të këtij personazhi i paraqet çifutët dhe natyrën e tyre si të dhënë pas lakmisë dhe grumbullimit të pasurisë. Hebrenjtë, që nga koha e daljes së kësaj shfaqjeje, kanë pasur ankth dhe kanë zhvilluar betejë kundër saj. Madje e akuzojnë Uilliam Shekspirin si antisemitist(7) dhe po të mos ishte vlera artistike e kësaj veprë dhe shkruarit të saj, do të humbej fare nga arkeologjia kulturore-letrare.(8)

Kjo vepër e Shekspirin është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga Skënder Laurasi dhe është botuar nga shtëpia botuese “Mësonjëtorja e parë” në vitin 2000.

Legjislacionet e vendeve evropiane kanë vazhduar ta trajtojnë kamatën si të ndaluar deri në kohën e revolucionit francez të vitit 1789. Pas kësaj është lejuar kamata në borxhe me disa kufizime. Ky lejim është transformuar edhe në kodifikimet ligjore të Napoleonit, të cilat janë nxjerrë në vitin 1804.

Pas vitit 1808 Franca përcaktoi sasinë e kamatës 5-7% e cila lejohet të merret gjatë transaksioneve tregtare dhe punëve të tjera. Në Francë, në gusht të vitit 1935 doli një ligj që përcaktoi se kush përfiton nga kamata jashtë shumave të kufizuara, llogaritet se ka shkelur kodin penal. Ndërsa në legjislaturën italiane, neni 644 i kodit penal pohon se, ai që punon me kamatë jashtë shumës së përcaktuar llogaritet se ka shkelur ligjin penal.(9)

Edhe në ditët tona shohim se

ndërgjegjia njerëzore nuk ka arritur të çlirohet nga urrejtja e kamatës dhe konsiderimin e saj krim, mëkat, vepër e pamoralshme, qoftë edhe nëse te disa lejohet me disa përkufizime dhe përqindje të caktuara që i kanë vënë në transaksionet e ndryshme.

#### **Kamata dhe Kanuni i Lek Dukagjinit:**

Ndonëse dihet se burimet e mirëfillta të kanunit të Lek Dukagjinit janë nga feja e krishterë dhe ne sqaruar qëndrimin e saktë të krishterimit të hershëm rreth kësaj, vlen të ceket se edhe në këtë libër kamata është e ndaluar dhe nuk lejon që njerëzit të mes vete të huazojnë para me kamatë. Në të thuhet:

**500. “Kanūja njeft uhj të fjeshtë: sj të dhaëë ké më dhânë.”,**

do të thotë ashtu si të ka dhënë (huadhënësi) ashtu duhet t’ia kthesh. Pra, Kanuni nuk e pranon kamatën; nëse dikush huazon diçka, aq ka për të kthyer, s’ka huazime me interes. Ata që e njohin mirë këtë tekst dhe ligjet që përmban ky libër e kanë të qartë qëndrimin që ka ndaj kamatës.

#### **Kamata në Islam:**

Më lart përmendëm një historik të shkurtër rreth qëndrimit të ligjeve dhe sistemeve të mëhershme për marrjen e kamatës. Kjo ishte me qëllim që lexuesi të kuptojë se ndalimi i kamatës nuk është specifikë e jurisprudencës Islame, siç mund ta kuptojë tani në kohën bashkëkohore, pasi për dëmin e saj flasin vetëm myslimanët. Vërtet kamata është trajtuar gjithmonë si vepër e

shëmtuar dhe mëkat. Kjo më së qarti vërehet në mësimet hebraike dhe të krishtera, e posaçërisht në mësimet e krishtera, pasi ata theksojnë se (Dhiata e re) numërohet si vazhdimësi e mësimëve që i ishin dërguar profetit Musa (paqja qoftë mbi të) në Tevrat (Dhiatën e vjetër).

Por, me gjithë këto që u thanë dhe, pavarësisht se në zemrat e njerëzve në përgjithësi mbretëron bindja se puna me kamatë nuk është e pastër, prapëseprapë të gjitha sistemet që njihen te njerëzit sot, nuk i kanë mbijetuar vrullit bashkëkohor, që shkel të gjitha normat dhe bazat e njerëzimit dhe ndërgjegjes së lirë. Të krishterët, edhe pse e dinë qartë se kjo është mëkat në fenë e tyre, nuk arritën t’i

bënin ballë furtunës së transaksioneve të shumta që realizohen me kamatë, kështu ata u dorëzuan dhe në vend që t’i kundërvihen, i hapën rrugën lejimit të kamatës. Ata në fillim e lejuan, duke vënë kushtëzime dhe kufizime në përqindje, por tani askush nga ata nuk përmend dëmin e këtij mëkati.

Në anën tjetër Islami është sistemi i vetëm i cili ka mbetur në këtë betejë dhe vazhdon ta luftojë këtë ves, edhe pse është bërë përditshmëri e shumë njerëzve. Fatkeqësisht kamata është e pranishme edhe te disa myslimanë, të cilët iu dorëzuan këtij vrulli bashkëkohor, që s’mëshiron askënd. E megjithatë, prapëseprapë

**Në anën tjetër Islami është sistemi i vetëm i cili ka mbetur në këtë betejë dhe vazhdon ta luftojë këtë ves, edhe pse është bërë përditshmëri e shumë njerëzve.**



shumica e myslimanëve që kanë njo-huri dhe janë të vetëdijshëm për mësimet Islame i largohen asaj. Me qëllim që lexuesi të njoftohet rreth kamatës dhe ta kuptojë se sa është e dëmshme ajo, në vazhdim të kësaj teme do të flasim rreth përkufizimit dhe llojeve të kamatës, pastaj do të sjellim edhe dispozitën përkatëse rreth këtyre llojeve duke u mbështetur në argumentet e jurisprudencës Islame.

### **Përkufizimi i Kamatës në Islam:**

Në gjuhën arabe, kamatës i thonë **“Riba”**. Ky emërtim rrjedh nga folja **“reba, jerbu”**, që do të thotë: **“shtim, teprim dhe rritje”**.

Trajtimet e fukahave rreth përkufizimit të kamatës në aspektin terminologjik janë të shumta, disa janë më gjithëpërfshirëse dhe disa të tjera më pak. Për të mos e rënduar këtë shkrim duke përmendur përkufizime të shumta, do ta sjellim vetëm përkufizimin e juristëve hanefi, i cili është më i qartë dhe më i kuptueshëm. Ata thonë: **“Kamatë është ajo sasi e pasurisë e cila kushtëzohet të shtohet pa kompensim, gjatë transaksioneve (këmbimeve) të ndërsjella të pasurisë me pasuri”**.(10)

Në kohën bashkëkohore, krahas termit **“Kamatë”**, përdoren edhe disa emërtime tjera, sikurse **“Fajde”** dhe **“Interes”**. Këto terma janë më të përdorshme në fushën e ekonomisë dhe të bankave dhe kryesisht kanë për qëllim:

1. Pjesa e shtuar të cilën ia jep huamarrësi huadhënësit si kompensim

për pasurinë që ka huazuar, konform kushteve të caktuara(11).

2. Sasia e shtuar e kapitalit të cilin e fiton si kompensim depozituesi në bankë apo në arkat e kursimeve.

Edhe pse gjatë kontratave bankare apo lidhjeve tregtare bashkëkohore bëhet dallim në mes të kamatës dhe interesit, në aspektin e dispozitave përkatëse rreth këtyre transaksioneve në jurisprudencën Islame nuk ka dallim. Në Islam nuk ka dallim dispozita në mes kamatës, fajdesë apo interesit, por këto të gjitha janë të ndaluara (haram). Kjo është kështu qofshin këto transaksione akte të shitblerjeve apo kontrata të huamarrjeve dhe kredive (borxheve).

### **Klasifikimi i kamatës në Islam:**

Pak më lart sqaruar se kamata në kohën tonë ka disa emërtime, varësisht prej fushës dhe formës së kontratës që realizohet. Në jurisprudencën Islame, fukahat gjatë shtjellimeve të tyre bëjnë një ndarje tjetër të kamatës nga ajo që njihet tek ekonomistët. Ata theksojnë se ajo klasifikohet në dy lloje:

a) **Riba en-nesie -Kamata e shtyrjes apo vonesës.**

b) **Riba el-fadël - Kamata e shtesës apo tepricës.**

Në vazhdim do të paraqesim se çfarë nënkuptojnë fukahat me secilin lloj.

1) **Riba En-nesie (Kamata e shtyrjes apo vonesës):**

Ky lloj quhet edhe **“Kamata e borxhit”** dhe nënkupton shtimin e kushtëzuar, të cilin e merr huadhënësi nga huamarrësi për shkak të kohës që i ka lënë në dispozicion huamarrësit të paguajë borxhin(12).

Ky lloj i kamatës ka qenë prezent dhe shumë i përhapur tek arabët në kohën para ardhjes së Muhamedit, salAllahu alejhi ue selem, për atë disa dijetarë e kanë quajtur **“Riba el-Xhahilije”** do të thotë: **“Kamata e injorancës”**.

**2 - Riba el-fadël (Kamata e shtesës apo tepricës):**

Kjo kamatë quhet edhe **“Kamata e tregtisë”** dhe nënkupton shitjen e një malli që i takon mallrave të kamatës me një mall tjetër të njëjtë duke qenë njëri mall më tepër, apo shitja ose këmbimi i dy mallrave të njëjta me shtesë<sup>13</sup>.

Format e këtyre llojeve janë të shumta e të ndryshme dhe të sqarohen këto nevojitet një zgjerim të cilin nuk do ta bëjmë në këtë vend, shpresojmë se në ndonjë temë tjetër të veçantë do ta bëjmë.

#### **Dispozita Islame rreth kamatës:**

Kamata në jurisprudencën Islame është e ndaluar (haram) e tëra, qoftë sasi e madhe apo vogël dhe pa marrë parasysh në çfarëdo formë kontrate realizohet ajo. Kjo dispozitë mbështetet në tri baza thelbësore, që janë edhe burimet kryesore të legjislaturës Islame. Pra bazat nga të cilat nxirret dispozita e kamatës janë:

**a) Kur’ani, b) Suneti, c) Konsensusi (Ixmhai).**

Kamata është nga mëkatet e mëdha (kebair) dhe llogaritet një nga shtatë mëkatet shkatërruese (elmubikat), së bashku me shirkun, magjinë etj. (më poshtë do të sjellim hadithin që sqaron këtë).

Nëse njeriu e mohon ndalimin e kamatës, atëherë ai ka bërë kufër

(mosbesim), por nëse punon me kamatë duke mos e mohuar ndalimin, atëherë ai është mëkatar (fasik), i cili ka shkelur njërin nga mëkatet e mëdha(14).

**A. Ndalimi i kamatës në Kur’an:**

Dijetari i njohur hanefij Shemsudin es-Serhasi në librin e tij **“El Mebsut”** përmend pesë përfundime të ashpra me të cilat kërcënohet njeriu që punon me kamatë(15).

1) **Do të ringjallet sikurse ai që e ka kapluar shejtani:** Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata që e hanë kamatën (ditën e gjykimit), nuk ngrihen ndryshe vetëm se si ngrihet ai i çmenduri nga të prekurit e djallit. (kjo ndodh kështu) ngase thanë: “Tregtia është njësoj sikurse edhe kamata”! E Allahu e ka lejuar tregtinë, por e ka ndaluar kamatën.”** (Bekare, 275).

2. **Asgjësimi dhe zhdukja e pasurisë:** Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë mohues dhe mëkatar”** (Bekare, 276). Nënkupton zhdukjen dhe çrrënjosjen e pasurisë, apo largimin e bereqetit, mos përmbushjen e kënaqësisë dhe mos arritjen e dobisë nga ajo pasuri që fitohet me kamatë(16).

3. **Shpallje luftë Allahut:** Allahu i Lartësuar thotë: **“E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), ta dini se do të jeni në luftë me Allahun dhe të dër-**

guarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve ju takon kryet e mallit tuaj, askënd nuk dëmtoni, e as vetë nuk dëmtoheni.” (Bekare, 279).

4. Mosbesim (kufri): Allahu i Lartësuar thotë: “O ju që besuat, kini frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata.” (Bekare, 278).

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmoshën, Allahu nuk e do asnjë mohues dhe mëkatar.” (Bekare, 276).

Fjala “Kef-far, mohues”, e cila ka ardhur në fund të këtij ajeti do të thotë mohues i Islamit, nëse thotë se kamata është e lejuar dhe “Ethem, mëkatar”, nëse e ha dhe punon me kamatë(17).

5. Përhershmeria në zjarr të xhehenemit: Allahu i Lartësuar thotë: “E kujtdo që i vjen këshilla nga Zoti i tij e shmanget prej kamatës, malli i tij, i fituar më parë (para ndalimit të kamatës), është i tij dhe çështja për këtë i takon Allahut. E, kushdo që i kthehet (punës me kamatë, pas ndalimit) ai do të jetë banues i zjarrit, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë.” (Bekare, 275).

Këto ajete të sures Bekare që u përmendën ishin vetëm disa prej ajeteve që aludojnë për ndalimin kamatës dhe se sa mëkat i madh është kjo vepër. Kemi edhe ajete tjera që vërtetojnë këtë gjë, por do të mjaftohemi

me kaq.

## B. Ndalimi i Kamatës në hadithe peygamberike:

Sa i përket thënieve të Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, të cilat flasin rreth kamatës janë të shumta dhe mund të ndahen në dy lloje:

a) Hadithe që flasin për ndalimin, dëmin dhe rrezikun e kamatës dhe njeriut i cili merret me të.

b) Hadithe që tregojnë disa forma konkrete të shitblerjeve dhe akteve të cilat përmbajnë kamatë dhe janë të ndaluara.

Ne do të përmendim vetëm disa thënie që tregojnë dëmin dhe ndalimin e kamatës:

1. Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “*I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshi mbi të, ka mallkuar atë që e ha kamatën, ai që ushqen kamatën (e jep atë), ai që e evidëncion atë si dhe ata që janë në cilësinë e dëshmitarëve në kontratën ku ekziston kamata.*” Dhe tha: “*Të gjithë këta janë të barabartë*” (Shënon Buhariu dhe Muslimi). Të argumentuarit e hadithit për ndalimin e kamatës është shumë i qartë, sepse i Dërguari, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, nuk mallkon për një vepër, e cila nuk është e ndaluar dhe nuk sjell mëkat. Gjithashtu ky hadith, siç shihet, i përfshin të gjitha palët në mallkim, edhe atë që e jep po edhe atë që e merr, edhe atë që e shkruan edhe atë që dëshmon për këtë kontratë.

2. Ebu Hurejre, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ue

selem, ka thënë: “*Largohuni prej shtatë mëkateve shkatërruese (rrenuese). Shokët e tij i thanë: O i Dërguar i Allahut, cilat janë këto mëkate? (Ai) Tha: ”Të bërit rival Allahut (shirku), magjia (sihri), mbytja e njeriut që e ka ndaluar Allahu me përjashtim nëse këtë e kërkon drejtësia (e fesë), keqpërdorimi (ngrënia) i pasurisë së jetimit, ngrënia e kamatës, ikja nga fushëbeteja dhe shpifja ndaj grave të ndershme besimtare” (Shënon Buhariu dhe Muslimi).*

3. Semure b. Xhundub transmeton se i Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Kam parë natën e (Miraxhit) dy melekë. Erdhën dhe më nxorën në tokën e shenjtë. Pastaj u nisëm dhe arritëm te një lum prej gjaku. Në këtë (lum) qëndronte një njeri. Ai qëndronte në mes të lumit, e në (breg të lumit) qëndronte një tjetër, përpara të cilit gjendeshin gurë. Sa herë që njeriu në mes të lumit rrihte të dilte, tjetri (nga bregu i lumit) e gjuante me gurë në gojë dhe e kthente në vendin ku qëndronte. Kështu vepronte sa herë që rrihte të dilte, e gjuante me gurë në gojë dhe njeriu kthehej përsëri aty ku qëndronte. Pyeta: Kush është ky? (Meleku) M’u përgjigj: Ai që gjendet në mes të lumit është njeriu që ka ngrënë kamatën”. (Shënon Buhariu).*

4. Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Kamata është shtatëdhjetë lloje mëkatesh, më e lehta është sikur njeriu të martohet me nënën e vet(18).*” (Shënon Ibn Maxheh dhe Albani e cilëson të saktë).

5 - Ibën Mes’udi transmeton prej të

Dërguarit të Allahut salallahu alejhi ue selem, se ka thënë: “*Çdonjëri që merr kamatë shumë, në fund përsëri pasuria do t’i pakësohet(19)*”.

### C. Ndalimi i kamatës me konsensus (Ihxma) të myslimanëve:

Me konsensus (Ihxma) nënkuptojmë unitetin e dijetarëve islamë (muxhtehidëve) për një dispozite sheriatike rreth një çështje të caktuar(20). Ixhmai është argument i fuqishëm legjitim për të vërtetuar dispozitat e jurisprudencës Islame.

**Duke u mbështetur në këtë, theksojmë se në ndalimin e kamatës kemi ixhma te myslimanët. Këtë konsensus e përcjellin një numër i dijetarëve dhe ata theksojnë se, edhe pse kemi disa mospajtime të thjeshta rreth disa formave të caktuara të kamatës në përgjithësi në këtë ka unanimitet (ixhma) të dijetarët e metit(21).** Për këtë vërtetohet nga myslimanët e parë, shokët e Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, se u tërhiqnin vërejtjen njerëzve që merreshin me tregti të mos e bënin këtë para se të mësonin gjërat thelbësore që kanë të bëjnë me tregtinë. Kjo ishte me qëllim që të mbroheshin nga tregtitë e ndaluara (haram) dhe syresh që përmbajnë kamatë. Prandaj vërtetohet se Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thoshte: “Mos të tregtoj në tregun tonë ai i cili nuk ka mësuar (rregullat e tregtisë), përndryshe ai do ta ngrejë kamatën (duke mos ditur)”(22).

(1) Shih: “Mexheletul Buhuthel Islamiye”, vëll. 31, f. 123, punimi shkencor me titull: “Talík Anit-Tefrik Bejnel-Faide el-Benkije Ver-Riba”, dr. Salih Elhusejin

(2) Shih temën: “Tarih Tahrimir Riba fil Alem”; gjithashtu shih: “Nahve Fehm Nidham Bunuk el-Islamiye” Xhemaludin Atije.

(3) Shih temën “Civilizacija i Kultura” cila gjendet ne internet; gjithashtu citatet e këtilla të marrura nga Talmudi janë të përhapura në shumë gjuhë, neper forume.

(4) Shih “Bibla”, psalmi 15:5 dhe në disa vende tjera; gjithashtu shih temën: “Eliktisadul Muasir Bidun Riba”, dr. Salah Sultan;

(5) Shih temën: “Uvod u Finansijsko Trzhishte”, dr. Dejan Sokic, fakulteti ekonomik, Beograd; gjithashtu shih “Nahue Fehm Nidham Bunuk el-Islamiye” Xhemaludin Atije.

(6) “Err-rriba Fi Nedheril Kanunel-Islami”, Muhamed Abdullah Draz, f.376.

(7) Edhe pse thuhet se ka qenë anëtarë në lozhën masoniste.

(8) Për më gjerësisht rreth kësaj shfaqje shih:

[http://en.wikipedia.org/wiki/The\\_Merchant\\_of\\_Venice](http://en.wikipedia.org/wiki/The_Merchant_of_Venice)

(9) Shih: “Mexheletul Buhuthil Islamiye”, vëll. 31, f. 123, punimi shkencor me titull: “Talík Anit-Tefrik Bejnel-Faide el-Benkije Ver-Riba”, dr. Salih Elhusajjin.

(10) “El Bahrur-raik”, vëll.6, f.135; “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.183.

(11) “El Muamelatel Malijel Muasire”, dr. Vehbe Zuhejli, f.240.

(12) El Muamelatel Malijel

Muasire”, dr. Vehbe Zuhejli, f.240.

(13) Më gjerësisht shih “Hashijetur Reudil Murbi”, Abdurrahman Nexhdi Hanbeli, vëll.4, f.493.

(14) “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.183.

(15) Shih “El Meksut” Es-Serhasi, vëll.12, f.109; “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.184.

(16) “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.184.

(17) “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.184.

(18) Shënon Ibën Maxheh dhe Albani e cilëson të saktë.

(19) Shënon Ibën Maxheh dhe hadithi cilësohet i saktë.

(20) Ixhmai ka disa definicione dhe ne në këtë vend nuk kemi për qëllim trajtimin e kësaj çështjeje, prandaj kemi përmendur shkurt çfarë kuptojmë më ixhma duke mos i përmendur brenda në definicion të gjitha kushtet të cilat duhet të plotësohen që një gjë të konsiderohet Ixhma.

(21) “Esh-sherhul Mumti Ala Zadil Mustakni”, Muhamed Ibën Uthejmin, vëll.8, f. 387; “Hashijetu Raudi Murbi”, Abdurrahman Nexhdi, vëll.4, f. 490 dhe të tjerë.

(22) Tefsir Kurtubi, vëll.3, f.352; “Fikhul Muamelat el-Malije el-Mukarin”, dr. Alaudin Zateri, f.185.

(23) Shiko “Xhamiul-Ahkamil-Kur’an” të Kurtubiut 10/ 303.

(24) Shiko "Tefsirul-Kur'anil-Adhim" 1/ 91.

(25) Shënon Tirmidhiu 5/ 253, 3049 he Nesaiu 8/ 286, 5540.

(26) Shënon Muslimi 3/ 1205, 1578.

(27) Shënon Buhariu 4/ 1631, 4216 dhe Muslimi 1/ 374, 525.





# Si të bëhesh nënë më e lumtur

- 8 mënyra si të fokusoheni në gjëra pozitive -

**Robert Barnett**

Gruaja dhe familja

**N**ëse pyesni një nënë a është më e lumtur tani që ka fëmijë, ajo me siguri do të thotë: po. Në gjithë botën, fëmijët janë në krye të listës mes gjithçka na bën të ndihemi mirë. Megjithatë, disa psikologë që analizojnë lumturinë, shpeshherë flasin për fakte që flasin ndryshe.

Të jesh nënë e fëmijës së vogël (sidomos nën moshën trevjeçare) është përvojë që ka vlerën e saj dhe na mbush me kënaqësi, por gjithashtu është përvojë që mund të ndikojë mjaft në gatishmërinë tonë. Ka raste kur ndiheni të lodhur, të ndrydhur dhe hera-herës të dëshpëruar, pohon Peter Ubel, profesor i mjekësisë dhe psikologjisë në universitetin e Miçiganit. Ka raste kur jepen në debate të ashpra me bashkëshortin dhe bini pre e emocion-

eve negative. Ka raste kur koha që kaloni me kujdesin ndaj fëmijës nuk është pjesa më e mirë e ditës. Në listën e aktiviteteve që u sjellin kënaqësi, kujdesin për fëmijët nënat e vendosin më poshtë se kënaqësia e ushqimit, ushtrimit dhe shikimit të televizionit. Këto fakte janë fryt i hulumtimit të kryer nga universiteti i Miçiganit, i cili ka përfshirë 900 gra. Nga ky hulumtim rezulton se kënaqësia që vilet nga kujdesi për fëmijët është pak më sipër kënaqësisë që vilet nga punët shtëpiake, nga puna në përgjithësi dhe nga drejtimi i makinës. Këto të dhëna nuk mund të mos shkaktojnë shokim te njerëzit, thotë Daniel Gilbert, profesor i psikologjisë në Harvard dhe autori i librit “të zbulosh rastësisht lumturinë”.

Njerëzit mendojnë që psikologët flasin se nënat nuk i duan fëmijët e tyre. Natyrisht, më shumë se çdo gjë (pas Allahut dhe të dërguarit të Tij sh.p.) nënat i duan fëmijët e tyre. Fëmijët sjellin me të vërtetë gëzim. Ata sjellin momente transcendentale që ju bëjnë të ndiheni aq të lumtur, sa që gjithë ai angazhim i madh rreth tyre duket se ia vlen.

### Paradoksi i lumturisë

Një nga shkaqet e prononcimeve kontradiktore të nënave dhe ekspertëve është kujtesa selektive. Kur psikologët në përgjithësi i pyesin nënat nëse duan që ta kalojnë kohën e tyre me fëmijët apo jo, pjesa dërmuese përgjigjen me po, sepse u kujtohen çastet e këndshme, loja në park, leximi i ndonjë libri...

Kur pyetja modifikohet dhe merr formën e pyetjes për rutinën ditore, atyre u kujtohen orët e kaluara gjatë përgatitjes së fëmijës për gjumë, për ushqim etj. Ndoshta llogaritësja e psikologjisë si shkencë, që nuk njih emocione, nuk arrin ta shënojë intensitetin e lumturisë së prindërve kur janë me fëmijët e tyre. Sipas Gilbertit: Ka momente që përfundimisht mund të shpallen fitues, kur në valle është lumturia. Fatmirësisht këto momente mund të na ndihmojnë t'i kapërcejmë ndrydhjet e përditshme.

Karen Reivich, bashkëpunëtoresh e hulumtimit në Qendrën e Psikologjisë pozitive pranë Universitetit të Pensilvani, thotë: Lumturia është diç më tepër sesa ndjenja e thjeshtë e gëzimit, lum-

turia përfshin edhe ndjenjën e lidhshmërisë me diçka që është më e madhe sesa ju vetë. Kur njerëzit orvaten të arrijnë diçka të lartë, ata e përshkruajnë jetën e tyre si të plotë, me kuptim dhe qëllim. Lumturia nuk është buzëqeshje në fytyrë, por fakt që në fund, ju përsëri do ta kishit bërë të njëjtën gjë (që ju jep lumturi).

Edhe ndjenja që dikush ka nevojë për juve është ndjenjë që na bën të lumtur. Mundi i investuar do tu kthehet dhjetëfish, thotë Elizabet Hauard, e ëma e Rejliut dyvjeçar nga Kalifornia. Fakti që jam bërë nënë e ka hapur një pjesë të zemrës time për të cilën nuk kam ditur se ekziston.

Sipas asaj hapi i parë për të qenë nënë më e lumtur është të vlerësoni punën që e kryeni si të rëndësishme. Hapet vijuese janë të gjeni metoda që atë punë ta bëni sa më të këndshme. Kështu ju do të ndiheni më mirë dhe do të bëheni nënë më e mirë.

Reivich e jep këtë shembull: Nëse bija juaj dyvjeçar dëshiron të pijë lëng nga gota e kuqe të cilën ju për momentin nuk mundeni ta gjeni atëherë nëse je e padisponuar mundesh të përgjigjesh me fjalën pi nga e kaltërta...por nëse mendon më pozitivisht atëherë merr një copë të kolazhit të kuq dhe ngjite përrëth gotës së kaltërt, kështu diçka që mundej të shndërrohej në konflikt të

**Hapi i parë për të qenë nënë më e lumtur është të vlerësoni punën që e kryeni si të rëndësishme.**

pahijshëm u shndërrua në diçka argëtuese. Lajmi i mirë për gjithë nënat është ky: Ju keni mundësi të mësoni si të fokusoheni në atë që është pozitive dhe si ta bëni atë shprehje të përditshme. Ja si:

### Pranoni se jeni nën presion

Ndoshta duket ironike, por e vërtetë është, se jeta e nënës fillon të jetë më e lehtë kur ajo kupton se të qenit nënë nuk d.m.th. jetë në ngrohtësi të vazhdueshme. Ndihejmon të kuptosh, se në rregull është që ndonjëherë, të ndihesh i frustruar, i lodhur, i hidhëruar dhe i ndjeshëm, thotë dr. Ubel. Kjo nuk do të thotë që ju jeni një prindër i keq. Bëhet fjalë thjeshtë për një të vërtetë normale.

### Plotësojeni orarin e gjumit

Shumica e dinë se lumturia nuk blihet me para por kush do të mundte të thotë se lumturinë e sjell gjumi i mjaftueshëm natën. Këtë e pohon studimi i kryer nga Universiteti i Miçiganit. Fakti që ju fitoni 60.000 dollarë në vjet nuk do t'ju bëjë më të lumtur ditën se sa një orë gjumi shtesë natën. Këtë e pohon autori i studimit Norbert Shvarc, profesor i psikologjisë. Misha Sauer, nënë e Rajlit njëvjeçar pohon se gjumi shtesë të cilin e bën gjatë vikendit kur bashkëshorti kujdeset për foshnjën e tyre shumë i ndihmon. Atëherë jam më e gatshme të bëj diçka tjetër, si për shembull të shëtis me bijën time në park.

### Rishqyrtoni prioritetet tuaja

Ndoshta duket e thjeshtë por një nga gjërat kyçe për disponim të mirë është organizimi i kohës që do të jetë më i plotë me veprime që i kryeni me kënaqësi. Për lumturinë me rëndësi është se si e harxhoni kohën tuaj e jo paratë thotë dr. Ubel. Nëse keni mundësi financiare e cila ju mundëson që kohën tuaj maksimalisht ta kaloni pranë familjes, bëjeni atë. Për shembull a është patjetër që çdoherë ju ta pas-

troni shtëpinë? Çfarë mendoni që ndonjëherë të paguani dikë që t'ju ndihmojë. Nëse këtë nuk mundeni t'ia mundësoni vetës atëherë mendoni sa e rregulluar duhet të jetë shtëpia juaj, a duhet që çdo ditë t'i rregulloni krevatet, ose atë kohë mundeni ta kaloni duke vizatuar më fëmijët tuaj. Punën jashtë shtëpisë a mundeni ta kryeni për gjysmën e kohës të cilën e keni paraparë?

### Relaksohuni

Koha e kaluar në veprime që ju kënaqin, si vrapimi ose rregullimi i kopshtit është e dashur për të gjithë. Sipas psikologëve personat me hobi janë më të lumtur se njerëzit pa ndonjë hobi. Keni fatin që para juve keni mësuesin e përshtatshëm për aktivitetet e tilla fëmijën tuaj. Për mua dhe ty çdo gjeth dhe mizë është e njëjtë por jo edhe kur në pyetje është një dyvjeçar thotë Reivich. Filloni që gjërat t'i vëzhgoni ashtu siç i shohin fëmijët, duke shikuar në detajet më të imëta.

Instalimi i cilësive më të mira që i keni në detyrat e edukimit të fëmijës, në shumicën e rasteve të thjeshta do t'ju mundësojë të ndiheni të rëndësishëm. Një ditë njëra nënë kishte përgatitur sendiça për fëmijët e saj duke imituar emisionin Kuzhina në TV. Një punë e thjeshtë u transformua në shfaqje me të cilën gjithë u kënaqem. Një nënë arkitekte së bashku me djalin e saj ndërtonin kulla prej rërës, ndërkaq nëna e tij me plot emocione fliste për historinë e shtyllave. Ndoshta fëmija e saj nuk ka kuptuar asgjë por dukej se si që të dytë kënaqen, thotë Reivich.

(Vazhdon...)

*Nga anglishtja: Talha KURTISHI*

# Fëmija dhe të folurit e tij

49

**Shkruan: Valbona KELMENDI**

**Në jetën praktike shpesh bëhet pyetja se kur fillon të folurit te fëmijët dhe si zhvillohet?**

Shumë shkencëtarë që janë marrë me të folurit e fëmijëve, shprehen se të folurit fillon në momentin kur fëmija lind. Disa thonë se lidhshmëria ndërmjet dëgjimit, të folurit dhe mendimit është shumë evident në

komunikimet njerëzore. Ata thonë: dëgjimi, të folurit dhe mendimi janë të lidhur ngushtë dhe çrregullimi i njërit prej këtyre tri elementeve ndikon shumë negativisht edhe në dy të tjerët. Pa dëgjim, nuk mund të zhvillohet të folurit, pa të folur, po ashtu, nuk mund të zhvillohet të menduarit, dhe pa të menduar nuk mund të zhvillohet personaliteti i njeriut.

Është i njohur nga të gjithë se fëmi-



Gravaja dhe familja

1 maj 2008  
25 Rehilul Ahir

albiSLAM

jët zhvillimin e të folurit e kalon nëpër disa faza. Lidhur me këtë shkencëtarët e këtij lëmi thonë se fëmija fillon nga e qarja e parë e sapolindur, gugatja, fillimi i krijimit të tingujve dhe fjalëve, krijimi dhe lidhja e tingujve në fjalë dhe fjali, zgjerimi i fjalorit dhe shprehja e lirë, pra, përvetësimi i të folurit.

Tek fëmija apo foshnja e porsalindur, të qarit e parë ka shumë rëndësi të madhe, sidomos për nënën e tij, sepse përmes këtij të qari tregon se ka lindur i gjallë. Ndërsa e qara e tij më vonë bëhet nga nevoja e tyre sociale të themi, sepse përmes të qarës tregon se ka uri, ka nevojë për pastrim ose ka ndonjë dhembje ose nuk i përgjigjet temperatura e dhomës etj.

Lidhur me këtë, të qarit e fëmijës më së miri e kupton ndjenja e nënës së tij në mënyrën se si qan fëmija i saj, nëna e kupton se çfarë kërkon fëmija. Për të mos i ikur qëllimit të diskutimit, po qe se dëshirojmë që fëmija të flasë më herët, duhet të flasim me të që nga dita e parë e lindjes së tij apo ardhjes së tij në këtë botë. S'do të thotë se fëmija e kupton se çfarë i themi, por realiteti është se fëmija e kupton dashurinë dhe ngrohtësinë, sidomos ngrohtësinë prindërore.

Është këshilluese që fëmijën mos ta

**Pa dyshim se komunikimi me njeriun në përgjithësi e sidomos me fëmijën ka rol të madh në jetë, sepse pa të folur nuk mund të shprehim dashuri, por gjatë të folurit me fëmijët duhet të kemi kujdes që të flasim gjithnjë gjuhën e pastër dhe asnjëherë të mos flasim gjuhën e fëmijës, por ata duhet t'i mësojmë që të flasin gjuhën tonë.**

lidhim me pelena kur është i zgjuar, por të lihet i lirë që të luajë lojërat e veta fëmijërore, mundësisht, nëna gjatë kësaj kohe t'i flasë fjalë të ëmbla e të buta. Të folurit me fëmijën (beben) duhet të jetë i ngrohtë, i butë, i buzëqeshur, i kthjellët, i dashur dhe gjithnjë bashkëbisedues me të, nëna duhet të jetë e kthyer më fytyrë nga ai, me qëllim që fëmija të shohë gojën e saj dhe mimikën e fytyrës se si e lëviz nëna kur i flet. E tëra kjo, sepse të gjithë fëmijët kanë nevojë për ngrohtësi dhe

dashuri, pa këto të dyja ndoshta edhe vështirë rriten.

Nëse ju kushtohet vëmendje më e madhe në muajt 6-8, kur ndahet veç të folurit e parë të fëmijëve nga ajo që quhet gugatje dhe i mësohen fjalët e para që ai mund t'i shqiptojë në këta muaj, p.sh. nëse shumë herë gjatë ditës i shqiptohet fjala Allah në vend të asaj mama, baba, papa etj (edhe pse janë tinguj fonetik buzorë), mendojmë se do ta ketë më lehtë të shqiptuarit e kësaj fjale më vonë, madje mund të themi se me shqiptimin e kësaj fjale në fillim, do të vihen më lehtë në binarë edhe fjalët tjera që do t'i thotë pas. Pastaj, me ta dëgjuar edhe rrethi më i gjerë familjarë i fëmijës shqiptimin e kësaj fjale nga fëmija i vogël, mendojmë se nuk do të



synojnë në shumë gjëra të tjera siç ndodhin në pjesën dërrmuese të familjeve, por do të ndalen dhe do të tregojnë respekt për këtë.

Pa dyshim se komunikimi me njeriun në përgjithësi e sidomos me fëmijën ka rol të madh në jetë, sepse pa të folur nuk mund të shprehim dashuri, por gjatë të folurit me fëmijët duhet të kemi kujdes që të flasim gjithnjë gjuhën e pastër dhe asnjëherë të mos flasim gjuhën e fëmijës, por ata duhet t'i mësojmë që të flasin gjuhën tonë.

Problemi është se, kjo dukuri, pra të folurit keq do të vazhdojë në të shumtën e rasteve tërë jetën e atyre fëmijëve, pasi edhe shkrim-leximi i takon të folurit, e këtë problem fëmija do ta bartë edhe në shkrim-lexim. Madje, shpesh për këtë dukuri fajësohen mësuesit, duke harruar se fajtorë janë prindërit, të cilët i kanë mësuar fëmijët e tyre që të flasin e veprojnë keq.

S'do mend se pengesa në të folur ndikon keq në suksesin e fëmijëve edhe në shkollë. Ka fëmijë shumë të zgjuar, por nga pengesa që kanë, nuk janë në gjendje që ta paraqesin dijen e tyre para mësuesit, kështu që ata edhe për buzën nga rrethi në të cilin gjenden. Lidhur me këtë, në mënyrë shumë të veçantë specifikojmë për ata fëmijë që i kanë pengesat në të folur të lindura. Këta fëmijëve duhet të ndihmohen nga të gjithë, të mos lejohet assesit të përqeshen nga të tjerët, por të jenë të përkrahur, sidomos nga prindërit, dhe të ndihmohen aty ku ngecin si dhe me një afrim të

përkushtuar ndjenjash të binden se kjo ngecje e tyre (belbëzimi) nuk është asgjë e aq më pak turp. Pastaj, për një gjë të tillë duhet të paralajmërohet mësuesi për "defektin" në të folur të fëmijës.

Jo rastësisht jemi fokusuar në këtë temë, kurse arsyeja është se, shumica e prindërve mundohen të arsyetohen se kanë edhe shumë punë të tjera, madje, kanë hallin e asaj se si t'i realizojnë kërkesat e tjera që i duhen fëmijëve të tyre (sigurimi i ushqimit, veshmbathjes etj..), por ne themi se, krahas hallit për obligimet e tjera të jetë hall i pa arsyetueshëm edhe fjalori i fëmijës dhe edukata e tij.

Problemi tjetër është se shumë prindër mundohen që të flasin si fëmijët e tyre, duke i imituar ata (p.sh., "lota e qeles lotulohet" - rrota e qerres rrotullohet), kështu që fëmija për shkak të moshës së njomë nuk mund t'i artikulojë shumë tingujt, prandaj, nëse prindi ose të tjerët flasin si fëmija, atë nuk e lejojnë për t'i mësuar artikulumet e tingujve fonetikë e që ata do ta vazhdojnë të folurit e gjymtë të themi, saqë të folurit e tyre do të jetë edhe i pakuptueshëm për rrethin ku gjendet.

Është realitet se fëmija në disa raste të caktuara mund ta humbasë të folurit e drejtë ose ta fshehë të folurit e drejtë, kjo më së shumti ka mundësi të ndodhë me lindjen e vëllait ose motrës pas tij ose të ndonjë frike që mund t'i paraqitet, si p.sh. lufta e fundit që ka lënë pasojat e saj tek

shumë fëmijë, në këtë rast themi se, nëse fëmija fillon ta humbasë të folurit e drejtë nga ajo që ai xhelozon lindjen e vëllait ose motrës, duhet të punohet me atë fëmijë në mënyrë shumë të kujdesshme dhe t'i flitet vazhdimisht fjalë të mira dhe bindëse se duhet ta dojë vëllain ose motrën e tij dhe se ai (vëllai/motra) janë të mirë etj...

Pastaj, në lidhje me këtë është se, fëmija më i rritur nga imitimi i vëllait ose motrës së tij, kur ai/ajo fillon të flasë me belbëzimet fëmijërore, mund ta humbasë të folurit e drejtë, andaj edhe kjo kërkon kujdes e jo të tejkalohet si diçka argëtuese, siç ndodh tek shumë prindër.

Pastaj është e këshillueshme që me dërgimin e fëmijëve në çerdhe, kopsht dhe parashkollore të kihet një kujdes, sepse aty ka fëmijë nga rrethe dhe prindër të ndryshëm e që fëmijët të kenë vese të cilat nuk duhet t'i marrin të gjithë fëmijët që rrinë me ta. Kjo për arsye sepse vetë prindi është ai që do ta vuajë pastaj në të ardhmen, sado që dikush mundohet t'ia hedhë fajin mësueses se s'ma ka edukuar fëmijën të flasë drejtë e të jetë i edukuar.

# A lejohen votimet?

**Pyetje:** A i lejohet një myslimani që jeton në një vend jo islamik të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare?

**Përgjigje:** Falënderimi absolut i takon Allahut, Zotit të botëve, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij! Çështja e shtruar rrok një problematikë që zgjidhet me *ixhtihad*, i nënshtrohet analizave dhe ekuacioneve në mes interesave të mundshme dhe dobive që pjesëmarrja në to mund t'u sjellë myslimanëve dhe dëmeve që eventualisht mund t'u sjellë një pjesëmarrje e tillë. Kështu, nëse dobitë që mund të vilen nga pjesëmarrja në zgjedhje janë më shumë sesa dëmet, atëherë kjo pjesëmarrje lejohet; nëse dëmet janë më të mëdha, nuk lejohet. Në bazë të kësaj që u tha, dispozita e daljes apo mos-daljes në zgjedhje dallon sipas vendit, shteteve, sistemeve, njerëzve etj. Kështu pra, nëse në një



shtet pjesëmarrja e myslimanëve në zgjedhje sjell dobi, kjo nuk përjashton mundësinë që ato të jenë të dëmshme në një vend tjetër. Kjo vlen edhe për kandidatët, pra, nëse disa njerëz mund të jenë të dobishëm për t'u votuar, nuk do të thotë se syresh të tjerë mund të cilësohen njësoj, kundër dallimeve përkatëse. Asambleja e Fikhut (*Jurisprudencës Islame*), lidhur me këtë çështje, pra “pjesëmarrja e myslimanëve në zgjedhje me jo myslimanët”, nxori këtë vendim:

*“Falënderimi absolut i takon vetëm Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut*

*qofshin mbi të Dërguarin e Tij të fundit, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij!*

*Këshilli i Asamblesë së Fikhut, në sesionin e tij të XIX, i mbajtur në selinë e Lidhjes së Botës Islame, në Mekën e nderuar, në periudhën 22–27.10.1428h, që përkon me datat 3–8.11.2007, përveç të tjerash shqyrtoi edhe çështjen e pjesëmarrjes së myslimanëve në zgjedhje me jo myslimanët në vendet jo islamike, temë e parashtruar nga sesioni i XVI, i mbajtur në intervalin prej 21–26.10.1422 h., që përkon me datat 5–10.01.2002, me qëllim të shqyrtimit të saj në mënyrë sa më analitike. Pas leximit të kumtesave dhe*

diskutimeve të anëtarëve rreth tyre, këshilli vendosi si më poshtë:

Pjesëmarrja e myslimanëve në zgjedhje me jo myslimanët në vendet jo islamike është çështjet e politikave të Sheriatit, në të cilat nxirret vendimi në dritën e ekua-cionit mes interesave dhe dëmeve, dhe kështu, vendimi mund të ndryshojë sipas kohëve, vendeve, rrethanave etj.

Për myslimanët që gëzojnë të drejtat e qëndrimit në një vend jo mysliman lejohet të marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe të ngjashme për shkak të interesave të shumta që arrihen nga pjesëmarrja e tyre në zgjedhje si p.sh. paraqitja e imazhit realist të Islamit, mbrojtja e interesave të myslimanëve në vendin e tyre islamik, arritja e të drejtave fetare dhe materiale të pakicave, forcimi i rolit të tyre në pikat e ndikimit, bashkëpunimi me organizmat e drejtësisë për të realizuar bashkëpunim të ndërsjellë të bazuar në drejtësi në për-puthshmëri me këto kritere:

që pjesëmarrësi mysliman në ato zgjedhje të ketë për qëllim kontributin e tij në arritjen e interesave të myslimanëve dhe largimin e dëmeve nga ta;

që myslimanët pjesëmarrës në zgjedhje të kenë parasysh se është më e mundshme që pjesëmarrja e tyre të çojë në efekte pozitive, nga të cilat përfitojnë vetë myslimanët e atyre vendeve duke forcuar pozitën e tyre, paraqitjen e kërkesave të tyre te organet vendimmarrëse dhe timonierët qeverisës, ruajtjen e interesave të tyre fetare e materiale;

që pjesëmarrja e myslimanëve në zgjedhje mos të rezultojë me diç që çon në mospërfilljen e tyre të Islamit.

Tek Allahu është i tërë suksesi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të dërguarin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe

shokët e tij.”

(Marrë nga:

<http://www.themwl.org/Fatwa>)

**Përktheu: Muhamed DËRMAKU**

**Pyetje: Hoxhë i nderuar, AbduRahman b. Nasir el-Berrak, cili është vendimi i fesë për votimet dhe pjesëmarrja në to? Cili është vendimi për hyrjen në parlament?**

**Dijetari AbduRahman elBerak dha këtë përgjigje:** Allahun e falënderojmë, paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhamedin, salallahu alejhi ue selem. Votimet që mbahen në vendet islame, pa marrë parasysh nëse kanë të bëjnë me zgjedhjen e kryetarit të shtetit, apo të deputetëve të parlamentit, është risi mes myslimanëve, ka ardhur tek ata nga popujt jobesimtarë, për shkak të zotërimit të tokave myslimane prej tyre dhe për shkak se shumë myslimanëve u pëlqejnë metodat e jobesimtarëve, edhe pse bien ndesh me logjikën dhe Fenë. Sepse përcaktimi i delegatëve bëhet në baza materiale, burojnë nga epshet dhe interesat njerëzore. Më pas, një defekt i këtyre kritereve lidhet me faktin se kandidati për kryetar shteti nuk propozohet nga populli; populli thjesht voton kandidatin e propozuar paraprakisht. Zgjedhja bëhet në bazë të propagandës, andaj ai që ka propagandë më të madhe dhe pretendime më të mëdha, ai fiton. Ata gjatë këtyre votimeve mbështeten në shumicën e votës, e cila vjen nga shtresat e ndryshme të popullit, duke shkaktuar barazi mes të mençurve dhe mend-

jelehtëve, dijetarëve dhe të paditurve, burrave e grave. Pastaj, numërimi i votave nuk është i ndershëm dhe i pastër; në to ka edhe rryshfete, premtime e mashtrime, të cilat ndikojnë jo pak. Kjo ndodh në vendet e cilësuar si vende të civilizuar, të “zhvilluara” dhe “demokratike”. Në vendet që ecin pas tyre, siç janë shtetet arabe dhe islamike, në zgjedhje nuk ka as realitet, as alegori. Kryetari mbetet kryetar dhe zakonisht votohet me 99% të votave, apo më shumë. Pos kësaj, ai që ka të drejtë të zgjidhet nga umeti, si inteligjentët, dijetarët, të mirët e umetit dhe ata që këshillojnë, ata që e dinë interesin e umetit në fenë dhe dynjanë e tyre, e në të gjitha çështjet sociale, ekonomike dhe politike, ata nuk kanë gjurmë në këto votime, këta janë “të larguarit”, nuk zgjidhen dhe nuk ka votë sipas tyre, ose i rrethuar me një shumicë dërmuese që ka të drejtë votimi dhe zgjedhjeje nga shtresat dhe grupime të ndryshme të shoqërisë. Kështu që është e qartë se këto votime janë shumë larg nga cilësia e zgjedhjes së Imamit (Kalifit), siç është përcaktuar në “rregullat e imamit” tek myslimanët. Po ashtu, edhe kushtet e të propozuarve në këto zgjedhje janë në kundërshtim me shumicën e kushteve të pranuar tek Imami, legjitimiteti i të cilit konfirmohet me zgjedhje, siç është përcaktuar në librat e fikhut islam. Nga kjo që thamë, është e qartë se këto votime janë risi mes myslimanëve dhe janë të kota, organizimi i tyre është haram, për shkak se është përngjasim me jobesimtarët,

mbështetet në propagandë, blerje të votave, pretendime të rrejshme dhe në shumicën mendjelehte, e cila i shet votat e veta, madje, ua jep votat atyre që realizojnë epshtet e tyre, duke mos llogaritur aspak moralin dhe fenë.

Kurse sa i përket pjesëmarrjes në votime dhe hyrjes në parlament, kjo është hapësirë e ixhtihadit; nëse sjell dobi të sigurt fetare, ndihmon të vërtetën dhe pakëson të keqen e zulumin, duke mos përdorur mëkat ose duke mos u mbështetur në ndonjë rregull të kufrit, ose të pajtohet me ndonjë vendim prej vendimeve të tagutit, që është në kundërshtim me sheriatin, pjesëmarrja në këtë formë është e ligjshme, duke e zbatuar ajetin Kur'anor: ***“Andaj, sa të keni mundësi ruajuni prej dënimit të Allahut, dëgjoni, respektoni dhe jepni për të mirën tuaj, e kush i ruhet lakmisë së vetvetes, të tillët janë të shpëtuarit”***. (Et-Tegabun: 16). Ai që mendon se pjesëmarrja sjell këto dobi dhe largon të këqijat, nëse kjo shoqërohet me nijet të mirë, atëherë nuk ka mëkat, e nëse mendon se pjesëmarrja e tij nuk sjell këto dobi dhe nuk garanton se nuk bie në vepra të kota, atëherë për të s'është gabim nëse i shmanget tërë këtyre grupimeve dhe i këshillon për hir të Allahut, këshillon për Pejgamberin dhe mbarë myslimanët, ashtu siç ka thënë Allahu, subhanehu ve teal: ***“Nuk është ndonjë mëkat për të dobëtit, as për të sëmuret, e as për ata që nuk kanë me çka të përgatiten, kur janë të sinqertë ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij, pra***



*për të mirët nuk ka rrugë qortimi. Allahu falë shumë, është mëshirues*". (Et-Teube: 91).

Kjo është ajo çka m'u lehtësua të përmbledh, Allahu e di më së miri.

*Përktheu: Bekir HALIMI*

**Pyetje:** Disa myslimanë që jetojnë në vende jo islamike, dëshirojnë të dinë nëse lejohet apo jo që të marrin pjesë në votime; më konkretisht këtu, nëse lejohet apo jo të votojnë për parti jo islamike. Thonë se, parti të caktuara, po të fitonin, do të mund t'i shërbenin myslimanëve?

**Dr. Muhamed Salih el-Munexhid dha këtë përgjigje:** Falënderimi i takon vetëm Allahut, subhanehu ue teal. Pyetja e shtruar përbën një nga çështjet ku fetvaja ndryshon sipas kohës, vendit dhe rastit. Lidhur me këtë çështje, nuk kemi të drejtë të japim një fetva, që do të vrente për çdo rast. Në disa raste, nuk është e udhës që myslimanët të marrin pjesë në votime, sidomos kjo në syresh ku myslimanët nuk përfitojnë asgjë, apo në të tjera, ku vota e myslimanëve nuk ka ndonjë ndikim te partitë e përfshira në votime, që do të thotë se, votuan apo s'votuan, çështja nuk ndërron. Kjo vlen edhe për raste të ngjashme, siç ndodh në rastet kur kandidati në votime ka qëndrim negativ ndaj myslimanëve, njëlloj si ai që ish para tij...

Mirëpo, ka raste kur nga votimi mund të vijë ndonjë dobi fetare, madje, dukshëm, siç mund të jetë zvogëlimi i konflikteve dhe dëmeve. P.sh., nëse njëri prej kandidatëve jo myslimanë tregon më pak armiqësi ndaj myslimanëve sesa tjetri, dhe, në anën tjetër, vota e myslimanëve ndikon në rezultatin e zgjedhjeve, në këtë rast themi se s'ka asgjë të keqe nëse votohet. Sidoqoftë, këto çështje mbështeten në rregullin e shariatit "dëmet dhe dobitë - el-mesalih uel mefasid". Për këtë duhet të pyeten dijetarët, që i njohin mirë përkufizimet e këtij rregulli. Çështja dhe rasti i atij vendi ku jetojnë ata myslimanë, ligjet e vendit, kandidatët, rëndësia për të votuar, rezultatet e çështje të tilla duhet t'u parashtrihen në detaje etj. **Askush s'ka të drejtë të mendojë se kush lejon votimet pajtohet dhe ndihmon kufrin, sepse kjo bëhet për dobinë e myslimanëve, jo për dashuri ndaj kufrit dhe qafirëve.** Dihet fare mirë se, myslimanët u gëzuan me fitoren e romakëve ndaj persianëve. Po ashtu, u gëzuan me fitoren e Nexhashiut ndaj atyre që donin t'i merrnin mbretërinë. Kjo dëshmohet qartë në librat e historisë, por ai që mendon të mos përzihet në votime, është i lirë. Fetvaja që dhashë vlen për votimet, ku mund të zgjidhen njerëz që do të ndikonin për të mirën e myslimanëve. Allahu e di më së miri.

*Përktheu: Omer BERISHA*

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.

Pyetjet mund t'i dërgoni në [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)

# Namazi nafile, vlera dhe llojet e tij

**AbdulAdhim b. Bedevij eIHALEFIJ**

**R**esulullahu salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kur të kryej ndokush prej juve namazin në xhami, le t’i caktojë një pjesë të namazit edhe shtëpisë së tij ngase për shkak të atij namazit Allahu do t’i bëjë dritë shtëpisë së tij.”*

Namazi i nafileve (namazi vullnetar) është dy lloje: i kufizuar dhe i pakufizuar.

Të kufizuar janë sunetet e rregullta të namazeve që ndahen në muekkede (të forta) dhe gajri muekkede (jo të forta).

Muekkede janë 12 rekate, katër rekate para Dreke dhe dy pas saj, dy pas Akshami, dy pas Jacisë dhe dy para Sabahut.

Gajri mukkede janë katër rekatet



Ilmihalli

para Ikindisë, dy para Akshamit dhe dy para Jacisë.

### **Disa sure që preferohet të lexohen gjatë disa nafileve.**

Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, në sunetin e Sabahut lexonte suren Kafirunë dhe Ihlas, kurse në herët tjera lexonte: *“O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahut, të Dërguarit të Tij, Librit që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij, dhe librit që e pat zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, melaikeve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të tij dhe Ahiretit, ai ka humbur tepër larg”* (Bekare: 136), dhe në të dytin: *“E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysin), tha: “Kush janë ndihmëtarët e mij për në rrugë të Allahut?” Havarijjetit i thanë: “Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut, ne u besuam Allahut, e ti dëshmo për ne se jemi myslimanë (të bindur, të dorëzuar)!”* (Ali Imran: 52)

### **Vitri, vendimi i shariatit dhe vlera e tij**

Namazi i Vitrit është sunet muekkede, namaz për të cilin ka nxitë Resulullahu salAllahu alejhi ue selem,. Ebu Hurejre, radijallahu anhu, thotë se Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Allahu është tek dhe e do tekun.”*

Koha e namazit të vitrit fillon me përfundimin e namazit të jaciisë dhe zgjatë deri në kohën e sabahut.

Është e pëlqyer të nxitohet në faljen e vitrit në fillim të natës për atë i cili frikohet se nuk mund të ngrihet në

fund të natës, kurse ai i cili mund të ngrihet në fund të natës, është e pëlqyer që të falet në atë kohë.

Vitri ka më së paku një rekat e më së shumti 11 rekate, pra mund të falet 3, 5, 7, 9 rekate. Nëse e falë vitrin 3 rekate, atëherë preferohet të lexojë sipas këtij rendi: suren A’la; Kafirun dhe Ihlas, rekatë për rekatë.

Namazi i vitrit dallon nga namazet tjera ngase në rekatën e fundit bëhet KUNUT. Duaja më e mirë që transmetohet në këtë drejtim është: *“ALLAHUMME IHDINI FIMEN HEDEJT UE AFINI FIMEN AFEJT UE TEVEL-LENI FIMEN TEVELEJT, UE BARIK LI FIMA E’ATAJT UE KINI SHERRE MA KADAJT FE INNEKE TAKDI UE LA JUKDA ALEJK, INNEHU LA JEDHIL-LU MEN UALEJT UE LA JE’IZZU MEN ADEJT, TEBAREKTE RABBENA UE TE’ALEJT.* – O Zoti im, më bëj mua prej atyre që Ti i ke udhëzuar dhe më bëj prej atyre që ti i ke falur, më bëj prej të dashurve Tu, më beko mua në atë që më ke dhënë dhe më mbro nga dëmi i asaj që Ti ke caktuar. Vërtet, Ti je Ai i Cili cakton dhe askush s’mund të caktojë kundër Teje asgjë. Me të vërtetë s’ka mposhtje për atë të cilin Ti e do dhe s’ka ndihmë për atë që është armik i Yt. I madhëruar dhe i Lartësuar je, o Zoti ynë”

### **Namaz i i natës**

Namazi i natës është sunet mustehab dhe është prej veçorive më të rëndësishme të të devotshmëve. Allahu thotë: *“Të devotshmit janë në kopshte e*

*burime. Të kënaqur se kanë marrë në dorë atë që u dha Zoti i tyre, ata edhe më parë (në dunja) ishin mirëbërës. Ata qenë të cilët pak flinin natën dhe në syfy (kah mbarimi i natës), ata kërkonin falje për mëkate. Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë, por, nuk lypë)."*

Ebu Malik Esh'ariu transmeton nga Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, i cili thoshte: "Në xhenet ka dhoma, pjesa e jashtme e tyre duket nga brenda, kurse pjesa e brendshme e tyre duket nga jashtë. E ka përgatitur Allahu për atë që u jep ushqim fukarave, flet butë, vazhdimisht aqjeron, dhe falë natën kur njerëzit flenë."

Edhe më tepër e pëlqyer është gjatë Ramazanit ngase Ebu Hurejre thotë se Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, nxiste me të falurit në namaz nate gjatë Ramazanit duke mos urdhëruar dhe thoshte: "Ai i cili fal namaz gjatë Ramazanit duke besuar dhe shpresuar në shpërblimin e Allahut, i falen mëkatet e mëparshme."

Namazi i natës fillon me një rekat e më së shumti 11, duke u bazuar në hadithin e Aishes, radijallahu anha, e cila thoshte: "Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, nuk shtonte mbi 11 rekate as në Ramazan e as jashtë Ramazanit."

Është e pëlqyer që gjatë faljes së namazit të natës, në Ramazan të falet me xhematë.

### **Namazi duha**

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, thotë: "Më porositi i dashuri Resulullahu

salAllahu alejhi ue selem, me tri gjëra. Më porositi të aqjëroj tri ditë nga çdo muaj. Të fali dy rekate "salatu-duha" edhe të fali vitrin para se të flejë." (Muslimi)

Ebu Dherri thotë se Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: "Për çdo nyje të trupit duhet dhënë sadaka, çdo lavdërim (subhanall-lah) është sadaka, çdo falënderim (elhamdulillah) është sadaka dhe çdo tahlil (la ilahe il-lallah) është sadaka, urdhërimi në të mirë është sadaka, ndalimi nga e keqja është sadaka, për të gjitha këto mjaftojnë 2 rekate të namazit duha." (Buhariu dhe Muslimi)

Namazi i duhasë më së paku ka 2 rekate. Koha e këtij namazi fillon që nga momenti kur dielli lind mirë, më shumë se dy shtiza.

### **Namazi pas abdesit**

Transmetohet nga Ebu Hurejra, radijallahu anhu, se Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, i ka thënë Bilalit, radijallahu anhu: "O Bilal, më trego për një vapë që ke punuar me më shpresë në Islam, se unë vërtetë kam dëgjuar krismat e të ecurit tënd në Xhenet." Ai (Bilali) i tha: "Nuk kam bërë gjë me më shpresë të vërtetë sesa dy rekate që i fali pas çdo abdesi."

### **Namazi Istihare**

Është pëlqyer që çdokush që do të bëjë diç të bëjë istihare (të kërkojë të mirën) nga Allahu, subhanehu ve teal. Siç tregohet në këtë hadith. Xhabiri thotë: "Na mësonte Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, istihare për çdo vepër ashtu siç na mësonte suret e Kur'anit dhe thoshte: "Kur vendos ndokush të bëjë një vepër, le t'i falë 2

rekate jashtë fardit, pastaj le të thotë: “ALLAHUMME INNI ESTEHIRUKE BI ‘ILMIKE UE ESTAKDIRUKE BI KUDRETIKE UE ES’ELUKE MIN FADLIKEL ‘ADHIM, FE INNEKE TAKDIRU UE LA AKDIR, UE TA’LEMU UE LA A’LEM, UE ENTE ‘ALAMUL GUJUB. ALLAHUMME IN KUNTE TA’LEMU ENNE HADHEL EMRE HAJRUN LI FI DINI UE MEASHI UE AKIBETI EMRI UE AXHILIHIVE AXHILIH FAKDIRHU LI VE JESSIRHU LI THUMME BARIK LI FIHI. UE IN KUNTE TA’LEMU ENNE HADHEL EMRE SHERRUN LI FI DINI UE MEASHI UE AKIBETI EMRI UE AXHILIH UE AXHILIH, FASRIFHU ANNI VESRIFNI ANHU UAKDIR LIJEL HAJRE HAJTHU KANE THUMME ERDINI BIH. – O Zoti im, me diturinë Tënde kërkoj mbarësi. Kërkoj ndihmë prej fuqisë Sate; kërkoj prej të mirave Tua të shumta, sepse Ti ke mundësi, Ti di çdo gjë kurse unë nuk di, Ti je ai që i di të fshehtat. O Zot, nëse kjo punë e imja (duke emërtuar nevojën) është e dobishme për fenë time dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen, ma mundëso mua që të realizohet kjo, ma lehtëso mua këtë dhe më beko në të. E nëse kjo punë është e dëmshme për fenë dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen largoje këtë nga unë dhe më largo mua nga kjo e më përcakto mirësinë kudo që të jetë dhe më bëj të jem i kënaqur me të” “Dhe në fund përmend veprën të cilën dëshiron ta bëjë”

### **Namazi i Kusufit (Eklipsit)**

Kur të nxihet Hëna dhe Dielli është e pëlqyer të thirret për në namaz tubues. Kur tubohen njerëzit në xhami fillon t’i fal imami 2 rekate në këtë formë:

Aishja, radijaLLahu anha, thotë: “U zu Dielli në kohën e Resulullahut salAllahu alejhi ue selem, u mblodhën njerëzit pas tij dhe u rreshtuan. Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, mori tekbinin fillestar, dhe lexoi lexim të gjatë, pastaj mori tekbin shkoi në ruku ku qëndroi gjatë. Pastaj u ngrit nga rukuja duke thënë: “Semi’allahu limen hamideh”. Por nuk shkoi në sexhde. Vazhdoi të lexojë gjatë, por më shkurtë se në të parin. Pastaj mori tekbin dhe shkoi në ruku, ku qëndroi gjatë por më shkurtë se herën e parë. Pastaj tha: “Semi’allahu limen hamide” “Rabbena lekel hama” (u ngrit nga rukuja) pastaj shkoi në sexhde. Kështu veproi edhe në rekatin e fundit. Kështu plotësoi katër rekate me katër sexhde. E doli Dielli para se të largohet Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, nga vendi ku fali namazin.”

### **Namazi Istiska – Për Shi**

Kur të ndërpritet shiu dhe të thahet toka, është e pëlqyer që të dilet në musal-la (vendfalje e madhe) për të falur namaz istiska. Falen dy rekate me imam. Duhet bërë lutje dhe kërkim falje shumë. Duhet kthyer pjesën e epërme të teshës ashtu që të jetë e djathta në të majtë (mbrapsht).

*Zgjedhi: Agim BEKIRI*



# Rruga e grupit të shpëtuar

dhe palës së ndihmuar  
(nga Allahu) në frymë të  
Kur'anit dhe Sunetit

Autor: Muhamed Xhemil Zejno



## Shkruan: Sedat SHABANI

**B**otimi i parë 1993, nga biblioteka “El kitabu ve sunneh”, Shkup, paraardhëse e shtëpisë botuese “Urtësia” – Shkup, e pastaj “Nun”.

Ky libër ka gjithsej 140 faqe; është një nga librat që ka pasur ndikim të madh te të rinjtë në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri, në edukimin dhe arsimimin me baza të shëndosha të Kur'anit dhe Sunetit dhe rrugës së të parëve tanë.

Libri në fjalë është lexuar gjerësisht edhe mes lexuesve myslimanë arabë në Lindje, pasi bëhet fjalë për një stil të lehtë dhe të kapshëm për të gjitha shtresat e popullit, e jo vetëm për

nxënësit e dijes, siç ngjet shpesh me këtë lloj literature.

Autori ka zgjedhur si moto të këtij libri hadithin e mirënjohur të Resulullahut, salAllahu alejhi ue selem, kur thotë: “*Pasuesit e Librit që kanë qenë para jush janë përçarë në shtatëdhjetë e dy grupe, e ky umet do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe, shtatëdhjetë e dy në Xhehenem, e një në Xhenet. Ai është xhemati*”. Ibën Haxheri thotë se hadithi është i mirë, i vërtetë (hasen sahih), transmetojnë Ahmedi dhe të tjerët. Pastaj sqaron cilësitë e këtij grupi, syresh që e dallojnë prej grupeve të tjerë, si duhet ta kuptojnë akiden, fjalën la ilahe il-lallAllah; po

ashtu, shtjellon disa nga temat me të cilat janë kundërvënë dijetarët e ehli Sunetit me bidatçitë, si p.sh, “Mëshiruesi qëndron mbi Arsh”, “përmendoret dhe vendet e shenjta”, “kremtimi i mevludit”, “Kur’ani është për të gjallët e jo për të vdekurit”, “të ngriturit në këmbë në mënyrë të palejuar”, “si duhen vizituar varret” etj.

Me këto tema dhe të ngjashme autori thyen shumë tabu dhe provokon kureshtjen e lexuesit dhe e shtyn njeriun të mendojë dhe të fillojë të analizojë njohuritë ose praktikën e tij të deritanishme, nëse syresh janë në përputhje me mësimet e mirëfillta të Islamit, apo janë peng i mësimëve të shtrembëruara dhe të trilluara, që janë përcjellë në shumë vende gjenerate pas gjenerate. Ky libër ka pa dyshim bereqetin e vet, pasi në botimin e parë ka gjetur përkrahje të lexuesit, ku shpesh edhe është fotokopjuar, në mungesë të kopjeve origjinale, që do të thotë se meritonte dhe kishte nevojë të ribotohej, e tashmë falënderojmë Allahun që na e bëri të mundur një ribotim të tij.

Libri është përkthyer nga Bekir Halimi, gjatë kohës kur ishte student në universitetin e Jordanisë në Aman, ku ndiqte edhe mësimet te shejh Albani rahimehullah, në fillimin e viteve '90. Allahu e shpërbleftë

për mundin e dhënë. Atë kohë Bekir Halimi solli edhe një libër tjetër nga i njëjti autor, “Akideja islame”, që pati jehonë të madhe te lexuesit, si ky libër që po ju paraqesim.

Muhammed Xhemil Zejno është sirian, jeton dhe vepron në Mekë. Pas botimit të parë të librit pata nderin që, së bashku me përkthyesin, të isha mysafir tre ditë, me ftesë të autorit, në shtëpinë e tij në Azizije, ku për faktin se ishim myslimanë

shqiptarë dhe kishim kontakte me shejh Albanin, na mirëprititi me shumë respekt dhe përkushtim. Vetë Muhamed Xhemil Zejno e quante veten nxënës i shejh Albanit, nga leximi i librave të tij, dhe pohonte se shejh Albani ka qenë frymëzuesi i tij në udhëzimin në mësimet e Kur’anit dhe Sunetit dhe traditës së gjeneratës së parë të Sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Sakaq, vlen të përmendim se në botimin e dytë libri është ndrequr në disa gabime që haseshin në botimin e parë, sikundërse vlen po ashtu të vëmë në pah se janë hequr disa tema nga origjinali i arabishtes; duke qenë se bëhet fjalë për disa anomali dhe tradita të shëmtuara që janë evidente tek arabët, kurse te ne nuk janë, e pamë të udhës të mos i përkthejmë dhe botojmë në gjuhën shqipe.

Allahu i shpërbleftë të gjithë ata që mundësuan ribotimin e këtij libri.

**"Pasuesit e Librit që kanë qenë para jush janë përçarë në shtatëdhjetë e dy grupe, e ky umet do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe, shtatëdhjetë e dy në Xhehenem, e një në Xhenet. Ai është xhemati".**

# Tituj të ri nga Sh. B. "NuN"



1. Tevesuli  
autor: Muhammed Kheril Zejno






2. Si të ballafaqesh me neftin  
autor: Muhammed ibn Muhamed Es-Selhan



3. Feja ime  
autor: Muhammed ibn Muhamed Es-Selhan



4. Rruga e grupit të shpëtuar  
autor: Muhammed Kheril Zejno







**\* FLUGGER GJALLËRON DHE ZGJATË JETËN E AMBIENTIT TUAJ.**

**\* MBI 3000 NIANSA TË NDRYSHME**

F.a.g - Kom  
Shkup - Maqedoni

Tel : + 389 (2) 2600 154  
Faks : + 389 (2) 2601 248  
rr. Xhon Kenedi nr. 9a lok.14

E-mail : [fag\\_color@yahoo.com](mailto:fag_color@yahoo.com)  
Web : [Flugger.com](http://Flugger.com)